QERSHOR 2022

# PROGRAMI VJETOR

## PËR PUNËN E SHFK,,KIRILI E METODIJ" F.RRAMANLI – KUMANOVË PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023

kiril.metodij@gmail.com







SHFK,, KIRILI E METODIJ"
F. RRAMANLI – KUMANOVË
PËR VITIN SHKOLLOR 2022/ 2023

Korrik 2022

## PËRMBAJTJA

- **Hyrje** ...........................................................................................
- **Letërnjoftimi i shkollës**..........................................................
- Të dhënat e përgjithshme të shkollës ........................................
- Kushtet hapësinore për punë në shkollë………………………...
- Kushtet – materialo-teknike………………………………………
- Harta e shkollës ……………………………………………...
- Struktura e shkollës ……………………………………………
- Kuadri mësimor dhe jomësimor..............................................
- Niveli i përgartitjes arsimore të punësuarve .............................
- Struktura e moshës së të punësuarve.........................................
- Nxënësit ..........................................................................................
- Misioni............................................................................................
- Vizioni ...........................................................................................
- Përvoja të fituara ...........................................................................
- Fusha të ndryshimeve, prioritete dhe qëllime……………....
- Plane aksionale..............................................................................
- Plani për evaluim të planeve aksionale……………………..
- Kriteret për sukses ……………………………………………
- Instrumenetet………………………………………………..
- Indikatorët e suksesit.......................................................................
- Planifikimi dhe organizimi i procesit edukativo-arsimor
- Kalendari i punës ..........................................................................
- Lloji i mësimit..................................................................................
- Organizimi i Mësimit të detyrueshëm………………………....
- Mësimi zgjedhor…………………………………………………
- Mësimi plotësues ………………………………… ………..
- Mësimi shtues …………………………………………………
- Programe të individualizuara për nxënësit talent ……………..
- Programe të individualizuara për nxënësit me nevoja të veçanta
- Projekte që realizohen në shkollë……………………………..
- Shfrytëzimi i TIK në procesin mësimor..................................
- Vlerësimi……………………………………………………...
-Lloje të vlerësimit dhe kalendati i vlerësimit…………………..
- Ekipi për përcjellje, analizë dhe përkrahje…...........................
- Vetëevaulimi i shkollës...................................................................
-Aktivitetet jashtëmësimore...................................................
- Sporti shkollor..................................................................................
- Seksione dhe aktivitete tëlira të nxënësve................................
- Garat shkollore................................................................................
- Puna shoqëroro humanitare .....................................................
- Ekskurzionet e nxënësve-----------------------------------------.
- Përkrahja e nxënësve

- Arritjet e nxënësve..................................................................
- Programe parandalues (kundër dhunës,kundër sëmundjeve të varësive,sjellje josociale, bashkëpunimi me organizata për siguri,dhe kujdes social).....................................................
- Siguria në shkollë...................................................................
- Klima pozitive socioemocionale................................................
- Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar
- Kujdesi për shëndetin…………………………………………
- Higjiena në shkollë..................................................................
- Kontrollime tsistematike..........................................................
- Vaksinimi..................................................................................
- Edukimi për ushqim të shëndoshë...........................................
- Klima shkollore dhe raportet në shkollë ……………………
- Disiplina....................................................................................
- Rregullimi estetik dhe funksional i hapësirës së shkollës .........
- Kodet etike................................................................................
- Multi – kulturalizmi..................................................................
- Rregullshmëria dhe sjellja e nxënësve ………………………
- Zhvillimi profesional i kuadrit mësimdhënës.........................
- Detektimi i nevojave dhe prioriteteve.......................................
- Aktivitete për zhvillim profesional...........................................
- Zhvillimi personal profesional..................................................
- Mësimi horizontal......................................................................
- Puna ekipore dhe klima shkollore............................................
- Përfshirja e familjes në shkollë ……………………………..
- Në Jeten dhe punen e shkollës……………………………
- Në Procesin e të mësuarit ……………………………………..
- Në Aktivitetet në shkollë………………………………… ………
- Në Vendim-marrje ……………………………………………
- Edukimi i familjes…………………………………………..
- Përgatitja e një broshure për prindërit......................................
- Bashkësia Lokale (pushteti lokal, komuniteti i biznesit)……
- Institucionet e Kultures…………………………………………
- OJQ të…………………………………………………………..
- Shoqata Sporti …………………………………………………
- Organizatat Shëndetsore……………………………………..
- Mediat (në mënyrë që të promovojnë shkollën) ………………
- Kodeksi për sjelljet e NXËNËSVE……………………………
- Kodeksi për të punësuarit……………………..............................
- Programi për aktivitete interne ne kuader te proektit INA (Integrimi nderetnik ne arsim )……………………….......
- Aktivet profesonale……………………………………….
- Këshilli i shkollës .............................................................
- Planifikimi zhvillimor ........................................................

- Plan per mbrojtje kunder zjarrit ,tërmetit,vërshimeve etj…………
- Plan per punen e keshillit te shkolles per vitin shkollor 2022/23
- Plan per punen e keshillit e prindërve……………………………
- Program për punën e këshillit të arsimtarëve……………………..
- Plani dhe programi i punes se drejtorit te shkolles per vitin shkollor 2022/2023……………………………………………………….
- Plani dhe programi i punes se pedagogut te shkolles per vitin shkollor 2022/2023…………………………………………………………..
- Plani dhe programi i punes se bibliotekistit te shkolles (2022-23)………………
- Puna në dokumentacionin pedagogjik shkollor ..........................

## Hyrje

**Shkolla fillore komunale „Kirili e Metodij„ f. Rramanli,** në pajtueshmëri me Ligjin për arsimin fillor. Në bazë te Ligjit për ndryshim dhe plotësime dhe në bazë të Ligjit për arsimin fillor (gazeta zyrtare e RM. nr. 103/2008), aprovuar me vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës).
Këshilli i shkollës në mbledhjen që u mbajt më **30.07.2021**, ___________e solli Programin vjetor për punën e shkollës në procesin edukativo-arsimor e cila do të jetë e dorëzuar në Komunën e Kumanovës dhe BZHA.
Ligjet e organizimit te punes në shkollë-( www.bro.gov.mk/osnovno obrazovanie ) , ( www.eduligje.mk )

Ky program vjetor do të dorëzohet në Komunën e Kumanovës dhe në Byronë për zhvillim të arsimit e njësisë rajonale Kumanovë.

### Letërnjoftimi i shkollës

| | |
|---|---|
| *Emri i shkollës* | *Shf periferike në ,fshatin Agino sell* |

| | |
|---|---|
| *Emri i shkollës* | *Shfk.,,Kirili e Metodij,,* |
| *Adresa* | *f. Rramanli* |
| *Komuna* | *Kumanovë* |
| *Fshati* | *f. Ramanli* |
| *Numri i telefonit* | *031/465181* |
| *e- mail* | *e-mail -kiril.metodij@mail.net.mk* |
| *E themeluar* | *Komuna e Kumanovës* |
| | |
| *Verifikimi i vitit* | 10-1121/3 09.06.1995 |
| *Gjuha mësimore* | *Gjuhë shqipe dhe gjuhë maqedone* |
| *Viti i ndërtimit* | *1994* |
| *Tipi i ndërtimit* | *E fortë* |
| *Hapsira e objektit* | *1029m2* |
| *Hapsira e oborrit te shkollës* | *6067m2* |
| *Shkolla punon në ndrrime* | *Në dy ndrrime* |
| *Mënyra e nxemjes së shkollës* | *Me naftë* |
| *Numri i klasave* | *I-IX* |
| *Numri i paraleleve* | *34* |
| *Numri i ndërrimeve* | *2* |

| | |
|---|---|
| *Adresa* | *f. Agino Sell* |
| *Komuna* | *Kumanovë* |
| *Fshati* | *f. Agino sell* |
| *Numri i telefonit* | *031/464 280* |
| *e- mail* | e-mail -kiril.metodij@mail.net.mk |
| | *Komuna e Kumanovës* |
| *Verfikimi numri i aktit* | |
| *Verifikimi i vitit* | *1995* |
| *Gjuha mësimore* | *Gjuhë shqipe dhe gj. maqedone* |
| *Viti i ndërtimit* | *1994* |
| *Tipi i ndërtimit* | *E fortë* |
| *Hapsira e objektit* | *320 m2* |
| *Hapsira e oborrit te shkollës* | *3500 m2* |
| *Shkolla punon në ndrrime* | *Në dy ndrrime* |
| *Mënyra e nxemjes së shkollës* | *Me parno me dru* |
| *Numri i klasave* | *I-IX* |
| *Numri i paraleleve* | *9* |
| | |

**Organ i administrimit të shkollës**

| | |
|---|---|
| **Këshilli I shkollës** | 1. Hajredin Xheladini-prind /kryetar<br>2.Nurtene Abdullai - arsimtar lëndor<br>3. Kadishe Bajrami - arsimtar klasor<br>4. Gazmend Isufi -anëtar -lokal<br>5 Llokman Muslii– prind-anëtar<br>6. Sanja Bajdevska – arsimtar<br>7. Stojko Sokollovski- prind-anëtar |
| **Këshilli I prindërve** | 1. klasa e pare<br>2.<br>3.Bajram Ademi<br>4. Senad Sheabedini<br>5. Vedat Abazi<br>6. Blerim Ajdini<br>7.Behar Ameti<br>8.Semir Abazi<br>9. Nazmi Kadrii<br>10.Arben Mrseli<br>11. Ajredin Xheladini<br>12.Bektesh Merseli<br>13. Rexhail Mrseli<br>14.Llokman Mirtezani<br>15. Bejtulla Mirtezani<br>16. Rizvan Ebibi<br>17. Qazim Xheladini<br>18. Musa Ebibi<br>19. klasa e pare<br>20. - Martin Krstevski komb paral<br>21. Martin Krstevski<br>22. Dalibor Zafirovski - kombi.paral<br>23. Dalibor Zafirovski<br>24. Dejan Dimkovski<br>25. Stojko Sokolovski<br>26.Dejan Dimkovski<br>27. Mirko Zafirovski<br>**Shf..Periferike Agino Sell** |

| | |
|---|---|
| | 28. klasa e pare<br>29. Mitra Bozhinovska<br>30. Kristina Milkovski<br>31. Lupco Nikolovski<br>32. Aneta Atanasovska<br>33.Милосавска Мирјана<br>34. Vlatko Spasovski<br>35. Aleksandra Bogdanovska<br>36. Kristina Petrovska |
| **Aktivet profesionale** | 1. Aktivet profesionale te grupi klasor<br>2.Aktivet Profesionale të shkencave natyrore<br>3.Aktivet profesionale e lëndëve gjuhësore |
| **Këshilli I klasave** | Këshillat e klasave I përbëjnë 18 Arsimtar klasor dhe 16 arsimtar lëndor |
| **Anëtarët e bashkësisë së klasave** | 34nxënës |

**Arsimatarët sipas gjuhës që e realizojnë mësimin dhe lloji i punësimit**

| | Gjithsejt | | Kohë e pacaktuar | | Kohë e caktuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjithsejt | femra | gjithsejt | femra | gjithsejt | femra |
| Gjithsejt | 58 | 36 | 49 | 30 | 9 | 6 |
| Gj.maqedone | 25 | 21 | 22 | 18 | 3 | 3 |
| Gj. Shqipe | 33 | 15 | 27 | 12 | 6 | 3 |
| | | | | | | |
| Gjithsjet | 58 | 36 | 49 | 30 | 9 | 6 |

**Shkalla e arsimimit të të punësuarve**

| Arsimimi | Numri i të punësuarve |
|---|---|
| Arsimi i lartë | 48 |
| Arsimi sipëror | 10 |
| Arsimi i mesëm | 3 |
| Arsimi fillor | 2 |

**Struktura e të të punësuarve sipas moshës**

| Viti | Numri i të punësuarve |
|---|---|
| 25-30 | 5 |
| 31-40 | 18 |
| 41-50 | 16 |
| 51- 64pension | 24 |

# MISIONI

**Nxënësit**
**tanë prej prindërve dhe**
**arsimtarëve të tyre**
***EDUKOHEN,***

**Në bankat shkollore**
**EDUKOHEN,**
***ARSIMOHEN,***

***Në hapsirat sportive***
***ZHVILLOJNË,, NË TRUP TË***
***SHËNDOSHË***
***MENDJE TË SHËNDOSHË,,***

**Në proces mësimor argëtime**
**dhe festime**
***SOCIALIZOHEN***

**E në GARA shkollore**
***PËRVETËSOJNË DITURI***

***PLOTËSUESE.MOTIVUESE***

**E ARDHMJA ËSHTË E**
**JONA**
**DHE AJO DO TË JETË MË**
**E NDRITSHME**
**PËR TË GJITHË NE**
**NË NJË SHOQËRI**
**MULTIETNIKE**


NXËNËSIT
sinqeriteti
bashkëpunim
toleranca
dialogu
respekti
mirëkuptim reciprok
multikulturalizmi
ARSIMTARËT
PRINDËT
SHOQËRIM

***VIZIONI***

***DUAM   QË SHKOLLA   JONË***

***TË JETË VEND PËR QËNDRIM***

***TË KËNDSHËM, EFIKAS, EDUKATIV***

***DHE***

***MËSIM   BASHKËKOHOR***

***SYNIMET***

Shkolla fillore komunale ,,Kirili e Metodij,," si institucion synon që të gjithë nxënësit që e ndjekin mesimin në kete shkollë pavaresisht nga veçoritë ,aftësitë psiko-fizike individuale, interesat, nevojat, motivet dhe qëndrimet ndaj mësimit dhe shkolles, të deshmojne nivele të kenaqeshme ,shumë të larta arsimimi, cilësi edukimi,duke ju ofruar gjithnje e me shume standarde bashkekohore per te qene konkurent te suksesshem ne shkollimin e mesëm,lehtësishte të integrueshem ne tregun e metutjeshem te punës si nxenes te botes se lirë demokratike, te pajisur me edukaten e te mesuarit gjate gjithe jetës.

***OBJEKTIVAT TONA***

 Të ulet vazhdimisht, deri në minimizim, numri i nxënësve që nuk arrijnë suksese në lëndët mësimore ,që kanë vështirësi në përvetësimin e

materijalit mësimor  që do të plotësojnë kërkesat/standardet minimale të shkollës.

 Të rritet ndjeshëm, nga viti në vit,në cdo klasë, numri i nxenesve qe arrijnë të deshmojne të plotesojnë në nivelet më të larta të avansuara kerkesat/standardet e shkollës.

 Puna me nxenesit e talentuar te shënderohet ne  te fuqishem te punes ne shkollë

 Te kemi progres e suksese të larta nga viti i kaluar sa i perket notes mesatare.

 Te parandalojme mungesat e nxënësve

## VIZIONI

Vizioni i shkollës fillore të integruar dygjuhësore  është krijimi i një cilësie , modeli kualitativ edukativo-arsimor i cili do të përfaqëson shembull adekuat për arsimimin e të gjitha bashkësive etnike në një ambient multietnik. Një shkollë e cila do të pasqyron ardhmërinë e sistemit edukativo-arsimor në shtetin tone  dhe më gjerë. Model i cili kujdeset, nxit dhe integron në vete: vlerat multietnike, dygjuhësinë, edukimin dhe arsimimin e nxënësve, prindërve të tyre, të punësuarve dhe bashkësisë nëpërmjet marrëdhënieve të hareshme, si dhe duke u bazuar në respektimin e dallimeve me qëllim që të krijojmë një familje multietnike  e shekullit 21.

Në periudhën e pushimit veror obligimet shkollore që ishin të parapara për fasadimin,ngjyrosjen e brendshëm dhe të jashtëm të objektit të shkollës si  dhe renovimi i klasave në objekt të realizohen  në kohën e planifikuar. Me fillimin e procesit shkollor nxënësit tanë do ti ndjekin mësimet në hapësirat shkollore të pastra , të dizenfektuara , të ndriçuara

dhe poashtu me kabinete të reja dhe mjete didaktiko metodike më bashkëkohore të biologjisë ,kimisë ,fizikës dhe informatikës.

Por planet tona nuk kanë të ndalur, shkolla është e realizuar projekti me nxemje qëndrore, ku përgaditim aplikacionet e të gjitha llogarive për finansim të projekteve. Poashtu në objektin shkollor qëndror dhe rajonale janë në plan të realizohen ndrrimi i dyerve të hyrjes në shkollën periferike dhe dritareve të objektit të cilat janë në hapsirën e vjetër.

Nga ana e Ministrisë së arsimit jemi të kyçur në proektin për ndërtimin e sallës sportive në oborrin e shkollës.

Me rregullimin e oborrit të shkollës nxënësve do t'iu mundësohet të ndihen më të sigurt dhe më të lumtur në gjelbrimin e hapësirave të oborrit të shkollës.

Gjithashtu edhe në shkollën periferike në f. Agino sell u realizuan projekti instalimi i nxemjes qëndrore, ndërtimi dhe rregullimi i hapësirës sportive ne oborrin e shkollës ,formimi i kabinetit të ri të informatikës, ndrrimin e dritareve , ndriçimin e hapësirave si dhe rrethimin e oborrit të shkollës janë në plan të realizohet edhe ndrrimi i dyerve të hyrjes së shkolles.

**MËSOJMË SË BASHKU**

Misioni i Shkollës tonë të integruar dygjuhësore është ndërtimi i një instituti edukativo-arsimor bashkëkohor, të suksesshëm dhe multietnik i cili do të ofron mësim kualitativ dygjuhësor nëpërmjet aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore. Institucion e përbërë nga intelektual kompetent dhe të dedikuar të cilët punojnë për shkollën tonë; bashkësi e cila kujdeset për zhvillim kualitativ dhe pa pengesa të procesit edukativo-arsimor. Të ofron hapësirë për nxitjen dhe shprehjen e aftësive individuale të talentit të nxënësve në një ambient me vlera multietnike; institucion e cila i mbindërton aftësitë dhe njohuritë personale nëpërmjet zhvillimit profesional; që kujdeset për komunikim dhe bashkëpunim efektiv me prindët dhe familjet e nxënësve, bashkësinë lokale, me organet shtetërore dhe përfaqësuesit e tyre.

Shkolla ka nevoje per pajisje teknike bashkëkohore digjitale me qëllim që të ofron një punë kualitative dhe mësim të suksesshme të shekullit 21.

***Shkolla jonë beson në:***

- Bashkëpunim dhe dialog të cilët ofrojnë zgjedhjen e problemeve ndërshoqërore.
- Respektimin e familjeve dhe bashkësive nga të cilat rrjedhin nxënësit tonë duke respektuar dhe vlerësuar dallimet e tyre etnike ,religjioze, sociale, gjuhën, kulturën, dhe traditat kombëtare.

- Nxënësit dalin nga kjo shkollë si personalitete të pasuruara me aftësi, kapacitete, dëshira dhe njohuri që të kontribuojnë në ndërtimin dhe shpërndarje të vlerave të vërteta në shoqëri, vlera të bazuara në respektimin e dallimeve, komunikim të hapur, dialog, tolerancë dhe konstrkuktivitet gjatë teljkalimit dhe shqyrtimit të konflikteve, kundër paragjykimeve dhe stereotipeve.
- Bazat e ndryshimit qëndrojnë në krijimin e një bashkësie që mëson, ndryshon e cila ofron nxënësve ti shfrytëzojnë dhe mbindërtojnë njohuritë e tyre në jetën e tyre të ardhme

Me qëllim që të realizojmë vizionin tonë, ne ndërtuam një "familje" të një trekëndëshi në shoqëri dhe në shkollën tonë:

## PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E SHKOLLËS
## Për vitin shkollor 2022-2023

Programi vjetor është dokument thelbësor mësimor në pajtim me dokumentet programore të Ministrisë për Arsim dhe Shkencë.

Në këtë dokument të rëndësishëm janë të përfshirë drejtimet apo fushat kryesore ku shkolla duhet të orientohet gjatë vitit shkollor 2022/2023.

Këtu janë të theksuara aktivitetet në nivel të shkollës, bartësit e këtyre aktiviteteve,koha e realizimit të tyre,përgjejgjësitë e subjekteve shkollore, si dhe efektet e rezultatet e pritura për realizimin e tyre nëqoftëse mundësojne kushtet epidimeologjike të pandemisë në këtë vit shkollor.

Me rëndësi është të ceket se Programi vjetor i shkollës në strukturën e saj mbështetet në planin zhvillimor të shkollës.

Shkolla fillore qëndrore ,, Kirili dhe Metodi,, f. Rramanli është shkollë qendrore ku i përfshin nxënësit të nacionalitetit maqedon dhe shqiptar nga i njëjti fshat edhe atë në mësim në gj. shqipe dhe gjuhën maqedone.

Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollën qëndrore dhe rajonale janë të përfshirë gjithsejt 385 nxënës, prej tyre në shkollën qëndrore në gjuhën shqipe 253 nxënës, në mësim në gj. Maqedone-56 nxënës ndërsa shkollën periferike në Agino Sell i përfshin gjithsejt 76 nxënës me mësim në gjuhën maqedone.

Në kuadër të kësaj shkolle punon edhe shkolla periferike (rajonale)në Agino Sell ku janë të përfshirë edhe nxënësit e fshatit Bërzak.

Në shkollën qendrore mësojnë 25 paralele prej I-IX.Në mësimin në gjuhën shqipe 18 paralele në gj. maqedone përfshihen 4 paralele të pastra, në mësimin lëndor nuk kemi paralele të kombinuara , ndërsa dy 2 paralele të kombinuara edhe atë II-III(kl. e dytë dhe e tretë )dhe IV-V (kl.e katërt dhe e pestë ). Në mësimin klasor në gjuhën maqedone për shkak të numrit të ulët të nxënësve klasat janë të kombinuara.

Në paralelet në gjuhën shqipe në procesin edukativo-mësimor janë të përfshirë 18 paralele prej të cilëve janë të evidentuar sipas programeve të inovuara( një paralele klasa e parë në gj. Maqedone dhe dy paralele në gj. Shqipe të cilët këta nxënës janë të përfshirë në aplikimin e arsimit dhe edukimit fillor nëntëvjeçar ).kjo vlen edhe në shkollën filloe periferike në Agino Sell procesi edukativo-arsimor zhvillohet me 9 paralele sipas programeve të konceptit nëntëvjeçar të inovuara në gjuhën maqedone.

Koncepti i ri i arsimit fillor njeh nevojën për ndryshim bazuar në njohuri të reja për zhvillimin e arsimit cilësor, trendet vropiane dhe botërore të arsimit bazuar në kompetencat, digjitalizimin e arsimit, si dhe të gjitha përvojat dhe aspiratat tona të mëparshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat tona që duhet të bëhet një vend për të mësuar dhe zhvillimin psiko –fizik të nxënësve të motivuar të gatshëm për të marrë kompetencat e pritura.

Gjithashtu, koncepti i ri respekton plotësisht perceptimet dhe mendimet e mësimdhënësve që janë vendosur nga hulumtimet e tyre. Kështu, koncepti i ri i arsimit fillor ofron ndryshime në disa fusha që lidhen me integrimin e lëndëve mësimore dhe të nxënit, përzgjedhjen e lëndëve me interes për nxënësin, mësimin përmes kërkimeve (hulumtimeve) dhe projekteve, zvogëlimin e ngarkesës së materialeve mësimore me të dhëna faktike-faktografike, përshtatja e mësimdhënies për nevojat e të gjithë nxënësve, përdorimi i materialeve të ndryshme mësimore, pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën shkollore, bashkëpunimi dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe motivimi i tyre me zhvillimin e karrierës, duke ofruar kështu mundësinë e ndërtimit të një shkolle sipas përmasave të fëmijëve.

Shkolla fillore ka statut , me statut veçanërisht rregullohen: organizimi dhe kryerja e veprimtarisë edukativo-arsimore, emërtimi, selia, menaxhimi dhe udhëheqja, të drejtat dhe obligimet e nxënësve, organizimiin xënësve, të drejtat dhe obligimet e të punësuarve dhe çështje tjera me rëndësi përpunën e shkollësfillore.

Statutin e shkollës fillore e miraton Këshilli i Shkollës, për statutin e shkollës fillore pëlqim jep Ministria, pas mendimit të marrë paraprakisht pozitiv nga themeluesi.

## PLAN – PROGRAMET MËSIMORE

Plani mësimor përmban lëndë të detyrueshme, lëndë zgjedhore dhe veprimtari të tjera të ofruara nga shkolla, të gjitha të shpërndara sipas klasave dhe sipas numrit të orëve në javë dhe në vit. Plani mësimor është baza për strukturimin e punës edukative-arsimore në nivelin shtetëror dhe për organizimin e saj në shkolla.

Lëndët mësimore të detyrueshme

Në planin mësimor janë të përfshirë lëndë të detyrueshme Lëndët: gjuhë maqedonase / shqipe / është definuar me gjuhën me të cilën realizohet mësimi (dhe për disa nxënës mundëson përvetësimin e gjuhës amtare) dhe del nga lëmi/fusha Shkrim – leximi gjuhësor nga Standardet nacionale për Arsimin fillor. Nga fusha Përdorimi i gjuhëve tjera të huaja lënda gjuhë angleze si lëndë e pare e huaj , gjuhë e dytë gjuha fringe po edhe gjuha gjermane prej vjet prej klasës së gjashte . Lënda shkencat natyrore përfshin tema/përmbajtje të cilat bëjnë pjesë në biologji, kimi, fizik dhe pjesët e gjeografisë dhe së bashku me lëndën Matematika drejtpërdrjetë del lënda Matematika dhe Shkencat natyrore nga Standardet nacionale, Këto tre lëndë janë të përfshira në të gjitha klasat, me fond të ndryshëm orësh.

Kjo fushë gjithashtu mësohet vazhdimisht, së pari përmes lëndës së shoqërisë (klasa I-III) dhe nga klasa IV përmes lëndës historisë dhe shoqërisë. Në lëndët e detyrueshme bëjnë pjesë arsimi figurativ dhe arsimi muzikor (që dalin nga lëmi të shprehurit artistike dhe kultura) dhe lënda arsimi fizik dhe shëndetësor (që lidhet me tregues të caktuar në fushën e zhvillimit personal dhe social) janë gjithashtu të detyrueshme. Secila prej tre lëndëve përfaqësohet në të gjitha klasat e arsimit fillor me të njëjtin fond të orëve. Nga periudha e dytë arsimore, futet lënda arsimi teknik dhe informatika, e cila del nga dy fusha të Standardeve nacionale: shkrimi dixhital dhe teknologjia dhe sipërmarrësia. Kjo lëndë është e pranishme edhe në periudhën e tretë arsimore, por ndryshimi nga njëra në tjetrën është në raportin e përmbajtjes - në klasat e ulëta theksi vihet në arsimin teknik, dhe në klasat e larta, në arsimin informatik. Në mes lëndëve të detyrueshme dedikuar nxënësve që nuk vijojnë mësimet në gjuhën maqedonase përfshijnë lëndën gjuhë maqedonase e cila mësohet në periudhën e dytë dhe të tretë të arsimit fillor (nga klasa IV në IX).

Me planin mësimor përcaktohet numri vjetor dhe javor i orëve për lëndët e obligueshme dhe zgjedhore ,orarin e tyre nëpër klasë,numrin e orëve javore për mësimin plotësues ,orët për mësimin shtues dhe orën për bashkësinë e klasës.

Me programet mësimore përcaktohen qëllimet mësimore ,përmbajtjet ,nocionet themelore,aktivitetet dhe metodat mësimore,notimi I arritjeve të nxënësve,kushtet për realizimin e programit mësimor dhe normativi i kuadrit mësimor.

Me programet mësimore përcaktohet shfrytëzimi i obligueshëm i teknologjive informatike–komunikuese në shkollë për realizimin e punës edukativo –arsimore.

Realizimi i programit mësimor në të gjitha klasat e do të ndiqet nga drejtori, shërbimi pedagogjik në shkollë si dhe Inspektorati shtetëror i arsimit.

Për këtë qëllim do të pregatiten instrumente për të vëzhguar fusha të caktuara që do të jenë objekt i analizës në orën mësimore ,plan-programeve mësimore etj.

Për këtë qëllim, do të ndërmerren aktivitetet e më poshtme:

-Bashkëpunim mes shërbimin profesional dhe aktiveve profesionale të mësimdhënësve të klasës I-IX dhe prindërve.

Nxënësit e klasës së katërt e pestë zgjedhin dy lëndë zgjedhore aktvitetet sportive rekreative dhe të arteve të lira p.sh.vizatimi,grafikë e dizajnim gjatë një viti shkollor - një për gjysmëvjetorin e parë dhe një tjetër për gjysmëvjetorin e dytë. Secili nxënës nuk mund të zgjedhë të njëjtën lëndë dy herë në një periudhë kohore, përveç nëse janë lëndë të së njëjtës fushë që janë në nivele të ndryshme (për shembull, Programimi 1 dhe Programimi 2). Lëndët e lira nga ajo që zgjidhet në një vit / gjysmëvjetor jo në realizimin e aktiviteteve në lëndën konkrete zgjedhore marrin pjesë nxënës të cilët ndajnë interesat e përbashkëta, pavarësisht nëse mësojnë në të njëjtën paralele (për shembull IVa ), në paralele të ndryshme të të njëjtit vit (për shembull, klasa VI), ose në vite të ndryshme brenda së njëjtës periudhë (për shembull, klasa VII-IX).

Planifikimi i programeve mësimore që bashkon disiplina të shumta (të tilla si Shkencat natyrore dhe Historia dhe shoqëria) përmban dy komponentë: planifikimin për pjesën e përbashkët të integruar dhe planifikimin për modulet individuale. Kështu, për shembull, për lëndën shkencat natyrore, janë planifikuar temat / njësitë modulare në fushën e biologjisë, kimisë, fizikës dhe gjeografisë, të cilat janë strukturuar në module të ndara (moduli biologji, moduli kimi dhe moduli fizik dhe moduli i gjeografisë), por gjithashtu, është planifikuar i ashtuquajturi Modul i Integruar i cili iu referohet temave/njësive modulare në fushën e biologjisë, kimisë dhe fizikës dhe/ose gjeografisë që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe merren me çështje të ngjashme.

Një planifikim i tillë kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm dhe punë ekipore të mësimdhënësve nga disiplina të ndryshme që ndajnë përgjegjësinë për realizimin e mësimdhënies së lëndës.

Kur bëhet fjalë për periudhën e parë të arsimit fillor (klasat I-III), mësimdhënësit kanë të drejtë të planifikojnë në mënyrë që të sigurojnë realizimin e mësimdhënies në tërësi - pa ndarje të dukshme sipas lëndëve dhe pa një kohëzgjatje të përcaktuar të orëve. Pritet që t'i mundësojë mësimdhënësit të rregullojë mësimin me moshën, nevojat dhe ritmin e përparimit të nxënësve me të cilët punon. Megjithatë, numri i përgjithshëm i orëve të ofruara për çdo lëndë individuale jepet në baza javore.

Mësimi interaktiv, ndërveprues përfshin zbatimin e qasjeve të bazuara në metodat e të mësuarit dhe të mësimdhënies që sigurojnë pjesëmarrje aktive të nxënësve përmes ndërveprimit të vazhdueshëm të mësimdhënësit me nxënësit, përmes bashkëpunimit midis nxënësve, përmes përdorimit të mjeteve audio-vizuale si ndërmjetës dhe përmes angazhimit të drejtpërdrejtë të nxënësit në realizimin e veprimtarive gjatë orës. Përveç qasjes interaktive, mësimdhënia bashkëkohore thekson si mësimin e bazuar në projekte, ashtu edhe atë të përvojës.

Përdorimi i informacionit dhe teknologjisë kompjuterike në arsim modernizon mësimdhënien - forcon kompetencat për të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjeron gamën e burimeve mësimore, rrit disponueshmërinë e mjeteve mësimore, sjell metodat e të nxënit dhe të mësimdhënies më pranë nevojave dhe interesave të nxënësve dhe i lehtëson ato vlerësimi i mësimdhënësve.

Infrastruktura e përshtatshme e shkollës dhe klasave është e nevojshme për realizimin e një mësimdhënie të tillë: internet i siguruar, pajisje me kompjuterë , disponueshmëri e përmbajtjes dhe mjeteve

dixhitale të mësimdhënies dhe mjeteve të tjera elektronike përkatëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie. E njëjta infrastrukturë lejon përdorimin e mjeteve elektronike për monitorimin dhe vlerësimin e nxënësve (të tilla si një portofol elektronik).

Aplikimi i veglave dixhitale që ndjekin praktikat më të mira (të tilla si interaktiviteti, gamifikimi, personalizimi) lehtëson mësimdhënien dhe të mësuarit sepse bazohet në metoda inovative që janë më afër interesave të nxënësve dhe kërkesave të jetesës bashkëkohore. Përveç kësaj, mësimdhënësit përdorin përmbajtje elektronike (të tilla si prezantime teksti, tabela digjitale.prezantime audio dhe video, dhe përmbajtje tjetër më të thjeshtë elektronike) që ata krijojnë vetë.

Mësimi është planifikuar në përputhje me nevojat dhe mundësitë e nxënësve. Kjo do të thotë që mësimdhënësi është në gjendje të identifikojë aftësitë e nxënësve dhe në përputhje me rrethanat të planifikojë një qasje të individualizuar dhe mësimdhënie të diferencuar. Gjatë planifikimit i përshtatë vëllimin dhe thellësinë e përmbajtjes, ritmin e punës dhe rezultatet e të nxënit që duhet të arrihen sipas aftësive dhe mundësive të nxënësve .

Shfk,,Kirili e Metodij,, f . Rramanli viti shkollor 2022-2023

Nxënësit në gjuhën shqipe në gjuhën maqedone

| Kujdestaret e klases | Klasa | parale | Numri i nxënësve | f | M | | Kujdestaret e klases | parale | Numri i nxënës | f | M |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shukrije | **I a** | **1** | **19** | 8 | 11 | **29** | **1** Buba | **1** | 4 | 2 | 2 |
| Caime | **I b** | **1** | **10** | - | 10 | | | | | | |
| Nesrine | **II a** | **1** | **15** | 9 | 6 | **26** | **II** Beti | **1** | **6** | 3 | 3 |
| Murtezan | **II b** | **1** | **11** | 3 | 8 | | | | | | |
| Xhemaledin | **III a** | **1** | **11** | 9 | 2 | **23** | **III** Beti | **1** | **7** | 5 | 2 |
| Besa | **III b** | **1** | **12** | 4 | 8 | | | | | | |
| Isnie | **IVa** | **1** | **7** | 3 | 4 | **15** | **IV** Aneta | **1** | **6** | 4 | 2 |
| Kadri | **IVb** | **1** | **8** | 2 | 6 | | | | | | |
| Kadije | **V a** | **1** | **15** | 7 | 8 | **30** | **V** Aneta | **1** | **6** | 1 | 5 |
| Fatjona | **Vb** | **1** | **15** | 7 | 8 | | | | | | |

| Gjithsejt | | 10 | 123 | 52 | 71 | | Kombinimi i paraleleve | 3 | 29 | 15 | 14 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Selver | **VIa** | **1** | **18** | 11 | 7 | **35** | **VI** Svetlana | **1** | **7** | 5 | 2 |
| Maire | **VIb** | **1** | **17** | 9 | 8 | | | | | | |
| Nuhi | **VIIa** | **1** | **17** | 10 | 7 | **35** | **VII** Milosh | **1** | **8** | 3 | 5 |
| Ilire | **VIIb** | **1** | **18** | 8 | 10 | | | | | | |
| Xemile | **VIII a** | **1** | **15** | 6 | 9 | **32** | **VIII** Marina | **1** | **6** | 3 | 3 |
| Lirim | **VIII b** | **1** | **17** | 7 | 10 | | | | | | |
| Sulejman | **IX a** | **1** | **12** | 4 | 8 | **25** | **IX** Lençe | **1** | **3** | 2 | 1 |
| Xelal | **IX b** | **1** | **13** | 5 | 8 | | | | | | |
| Gjithsejt | | **8** | **127** | **60** | **67** | | Gjithsejt | **4** | **24** | **13** | **11** |
| Gjithsejt | | **18** | **250** | **112** | **138** | | | **7** | **53** | **28** | **25** |
| | | | **250 nx** | | | | | | **53 nx** | | |

Në nivel të shkollës

| **Në nivel të shkollës** | Gjuhë shqipe | Gjuhë maqedone qëndrore | Rajonale | **2022/2023** |
|---|---|---|---|---|
| **-Femra** | **112** | **28** | **30** | **170** |
| **– meshkuj** | **138** | **25** | **40** | **203** |
| **- gjithsejt** | **250** | **53** | **70** | **373** |

| | Gjuhë shqipe | Gjuhë maqedone | - gjithsejt |
|---|---|---|---|
| **- gjithsejt nxënës** | 250 | 123 | **373 nxënës** |

viti shkollor 2022-2023

shkolla periferike f. Agino sell

| | Kujdestaret e klases | paralelja | Numri i nxënësve | ж | M | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | I Meri | 1 | 9 | 5 | 4 | |
| | II Roze | 1 | 5 | 3 | 2 | |
| | III Даniella | 1 | 9 | 4 | 5 | |
| | IV Dushica | 1 | 3 | 1 | 2 | |
| | V Keti | 1 | 3 | 2 | 1 | |
| | | | 29 | 15 | 14 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | VI Valentina | 1 | 12 | 4 | 8 | |
| | VII Emilija | 1 | 9 | 6 | 3 | |
| | VIII Suzana | 1 | 8 | 2 | 6 | |
| | IX Sawa | 1 | 12 | 3 | 9 | |
| | | | **41** | **15** | **26** | |
| | Gjithsejt | 9 | **70** | **30** | **40** | |
| | Gjithsejt | | | 70 nx. | | |

**Në pasqyrën tabelare janë të dhëna të dhënat sipas structures gjinore sipas përvojës dhe përgaditjes profesionale e të punësuarve në shkollen qendrore dhe rajonale**




| Vendi i punës | Gjinia | | Përvoja e punës | | | Mr. | Faku ltet | E lart | Mes me | Fillore | Gjithsejt |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Fe | M | Gje 10 | 10-25г | Mbi 25г | | | | | | |
| Drejtori | | 1 | | | 1 | | 1 | | | | *1* |
| Pedagogu | 1 | | | | 1 | | 1 | | | | *1* |
| Psikologu | 1 | | | | 1 | | 1 | | | | *1* |
| Arsimtarët | 35 | 16 | 22 | 20 | 9 | 2 | 32 | 17 | 1 | | *52* |
| Bibliotekisti | 1 | | | | 1 | | 1 | | | | *1* |
| Sekretaresha | 1 | | 1 | | | | | | 1 | | *1* |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbajtësit e higjienës | 2 | 3 | | 3 | 2 | | | | | 5 | *5* |
| Nikoqir i shkollës | | 1 | 1 | | | | | | 1 | | *1* |
| Gjithsejt | *41* | *21* | *24* | *23* | *15* | *2* | *36* | *17* | *3* | *5* | *63* |

## Planifikimi dhe organizimi i procesit edukativo-arsimor për vitin shkollor 2022/2023

Në shkollën tonë procesi edukativo-arsimor organizohet dhe realizohet në bazë Ligjit për arsimin fillor, plan-programeve mësimore të cilat me propozimin e Byrosë i verifikon ministri.
Detyra kryesore dhe më e rëndësishme e shkollës është organizimi i veprimtarisë edukativo- arsimore dhe pastaj në çdo fushë do të niset nga qëllimi,detyrat ,standardet dhe parimet bazë për organizimin e kësaj veprimtarie.
Për mënyrën e organizimit të mësimit dhe aktiviteteve tjera të shkollës fillore shfrytëzohet ligji për arsim fillor,si dhe udhëzimet e BZHA ,gjithësesi merret parasysh angazhimi i arësimtarëve. Plani mësimor i shkollës fillore përmban lëndë obliguese , zgjedhore ,mësim plotësues , shtuese si dhe orë për bashkësin e klasës.

Me këtë propozim rekomandohet mësimi në vitin shkollor të realizohet175 gjeri prej 180 ditë mësimore që parapraksht do të caktohet me kalendarin për mësim të miratuar nga Ministria e Arsimit, ku këtë vit shkollor, mësimi organizohet sipas plan-programit nga kl.I deri në të kl.IX.

Në Shkollë do të organizohen këto lëndë të mësimit:
-Mësim në lëndët obliguese
-Mësimi në lëndët zgjedhore
-Mësimi shtues
-Mësimi plotesues
-Orë për bashkësine e klasës
-Aktivitete të lira të nxënësve

-Vizita apo vëzhgimi i orëve mësimore nga drejtori dhe shërbimi pedagogjik, me qëllim që të ndiqet cilësia dhe realizimi i programeve të klasës I-IX;
-Biseda me nxënësit dhe prindërit rreth vështirësive në mësim;
- Bisedë dhe bashkëpunim mes arsimtarëve
-Zhvillimi profesional i mësimdhënësve përmes vizitave në seminare, organizimin e seminareve të brendshme dhe orë mësimore;
- Kontrollim permanent i njohurive të nxënësve duke përdorur vlerësimin formative dhe sumativ;
- Kontrollimi i njohurive të nxënësve nga kl.e katërt deri në klasën e nëntë nëpërmjet testeve të standarizuara .
- Analiza e rezultateve të arritura dhe marrjen e masave për arritjen e rezultateve më të larta.
Mësuesit punën edukativo arsimore dotë e realizojn me theks në risit në punë duke aplikuar format dhe metodat bashkohore, demokracisë dhe respektimit të dallimeve individuale në mesin e nxënësve.
Me qëllim të efikasitetit më të madh në procesin arsimor në kualitetin e njohurive dhe përparimin e nxënsëve do të thellohet bashkëpunimi mes nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve.
Për këtë qëllim mësuesit do të bashkëpunojë me drejtorin,shërbimin profesional, me këshilltarët e BZHA , me qëllim të vetëm, për të arritur realizimin më të suksesshëm të projekteve dhe rezultate më të larta të nxënësve.

### a) *Organizimi i mësimit të lëndëve të obliguara*

Mësimi obligativ do të realizohet për të gjithë nxënësit nga kl.I deri në kl.IX të në lëndët mësimore të parapara me plan programin mësimor : Gjuhë shqipe,maqedonase, angleze, franceze e gjermane (gjuha e dytë e huaj ), Ars.Teknik, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Inovacione kl.e IX , Etika, Informatika në VI-VII, arsimi teknik në IV,V dhe VI, arsim muzikor, arsim figurativ, arsim fizik shënd, Arsim qytetar dhe orën e bashkësisë së klasës.
Përfshirja e lëndëve mësimore në mësim sipas klasave dhe fondi javor për çdo lëndë janë të përcaktuara me Planin dhe programin mësimor.

Qëllimet, detyrat dhe përmbajtjet e mësimit në lëndë mësimore të caktuara janë të përcaktuara me programin mësimor, që çdo mësimdhënës i posedon në programet e tyre vjetore.

Procesi edukativo arsimore në shkollën fillore qëndrore „ Kirili e Metodij„f.Rramanli dhe shkolla periferike në f. Agino sell është baza dhe komponenta kryesore e rëndësishme në procesin –edukativo arsimore e cila ndikon në realizimin e qëllimeve edukative e mësimore dhe procesi edukativo arsimor është i organizuar në dy ndërrime Kreativitetin dhe socializimin e personalitetit të nxënësve në zhvillimin e diturive dhe në jetën e përditshme.

Byroja e zhvillimit për arsim ka dorëzuar drejtimet e Planifikimit dhe organizimit e mësimit për këtë vit shkollor.

Ndërsa paralelet tjera do të ndjekin mësimin me programet e mësimit të Konceptit nëntëvjeçar të shkollës fillore.
Në bazë të Ligjit për arsimin fillor e në lidhje me përcaktimin
e lëndëve zgjedhore në vitin shkollor 2022/2023, në shkollë është
realizuar anketimi i prindërve dhe nxënësve me
listat e ofruara me lëndë zgjedhore për secilën paralele.

***M ë si mi z gj e d h o r***

Gjatë muajit Maj përpara prindërve të nxënësve të kl.IV-IX sipas klasave,shkolla organizon anketime te lëndëve zgjedhore të parapara me plan dhe programin mësimor të shkollës ,të cilat do të realizohen gjatë këtij viti shkollor.Prindërit dhe nxënësit i zgjodhin këto lëndë zgjedhore:

| **Klasa** | | **Lëndët zgjedhore<br>në gj.maqedone dhe gj. shqipe** |
|---|---|---|
| VI | | Civilizimi evropian |
| IX | | Shkathtësite jetësore Agino |
| IX | | Shkathtësite jetësore - qëndrore maq. |
| VIII | | Hulumtimi i vendlindjes |
| VI a-b | | Etika e religjioneve |
| VII | | Shkathtësite jetësore |
| VIIIa-b | | Edukimi mbi mjedisin |
| IX-b | | Përparimi i shëndetit |
| IX -a | | Arsimi teknik |
| | | |
| | | |

Sipas dinamikës për realizimin e programeve të reja nga ana e Arsimtarëve bëhet planifikimi dhe organizimi i plan-programit mësimor.

- Ligji për arsimin fillor
- Plani e programi i procesit edukativo-arsimor
- Struktura globale e Procesit edukativo arsimore dhe
- Përvoja dhe rezultatet nga vitet e kaluara shkollore

Në lidhje me punën dhe rezultatet e arritura për vitin e kaluar shkollor mund të ceket organizimi i mirë në planin edukativ dhe arsimor,ku janë të konkretizuara temat,qëllimet ,detyrat ,drejtimet për realizimin e funksionit edukativ në shkollë.
Gjatë këtij viti shkollor do ti kushtohet vëmendje produktivitetit mësimor në planin edukativ,funksional ku do të plotësohen qëllimet kryesore në procesin edukativo-arsimor.

Të zhvillojmë aftësi intelektuale,fizike,krijuese dhe praktike në pajisjen e nxënësve me kulturë të përgjithsshme, nxitjen dhe afirmimin e aftësive të tyre,vlerat individuale të përgjithshme dhe të zhvillojmë personalitete të shëndosha psiko-fizike me shikim drejt të sotmes dhe ardhmërisë, ku do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë,të vërtetës për një jetë të shëndoshë dhe bashkëkohore.

Në procesin edukativo-arsimor do të përdoren metodat dhe format më bashkëkohore digjitale duke I kushtuar rëndësi aftësive psiko-fizike të nxënësve me procedura adekuate didaktiko-metodike.




Mësimi bashkëkohor realizohet përmes përkryerjes profesionale dhe pedagogjike ku nënkupton aftësimi për përdorimin e teknikave bashkëkohore interactive të cilat mundësojnë hulumtim dhe zhvillim më të madh dhe të shpejtë të aftësive ,shkathtësive diturive individuale të nxënësve.

Mësimi aktiv dhe interaktiv do të jetë prioritar si detyrë në programin e punës në këtë vit shkollor,ku të gjithë nxënësit nuk do të jenë pasiv në orët e mësimit,pastaj do tu jepet mundësia që të hulumtojnë për zgjidhjen e detyrave mësimore.

Me qëllim të profesionalizmit të arsimtarëve mbahen shumë seminare e ligjërata shkencore me entin pedagogjik si dhe këshilltarët të jenë vizitues të shpesht të shkollave, ku nëpërmes bisedave, sugjerimeve ndërrimit të mendimeve të ndikojnë në përgaditjen profesionale të arsimtarëve.

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore zhvillimore të lëndëve mësimore të matematikës dhe shkencave natyrore . Hulumtimi shkencor përfshin shqyrtimin e ideve, vlerësimin e dëshmive, planifikimin e punës hulumtuese dhe evidentimin dhe analizën e të dhënave.

Edhe në këtë vit si në vitin e kaluar do të kemi kontakte të vazhdueshme me prindërit,pasiqë kanë ndikim primar tek nxënësit dhe janë në bashkëpunim me trekëndshin prindër-arsimtar-nxënës.Pjesëmarrja active e prindërve në mbledhje të ndryshme dhe në organizime të ndryshme do të kontribojnë në përparimin e punës në shkollë,në përmirësimin e rezultateve të suksesit dhe në angazhimin vullnetar në shkollë,kështu fëmijët do ta ndjejnë shkollën si shtëpi të tyre të dytë.

## *Qëllimet Zhvillimore dhe Plani Zhvillimor*

Qëllimi zhvillimor – Rritja dhe përmirësimi i kushteve për punë.
Qëllimi zhvillimor - Rritja e cilësisë së mësimdhënies që nxënësit e përfitojnë njohuri te reja në shkollën fillore "Kirili e Metodij " përmes përdorimit të mjeteve elektronike të teknologjisë moderne të mësimdhënies .
Qëllimi zhvillimor –Zhvillimi profesional i kuadrit mësimor në përputhje me trendet bashkokohore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
Qëllimi Zhvillimor -Rritja e ndërgjegjësimit të ruajtjes së mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të punës në shkollë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore permes iniciativës Kompjuter për secilin fëmijë, e pajisi shkollën me kompjuterë, me çka të gjithë nxënësit kanë qasje në mesime dhe përfshin- kompjuterë llap-top që do të përdoren për mësimin klasor e lëndor.
Në këto kompjuterë është instaluar sistemi operativ ku të gjitha aplikacionet janë të lokalizuara në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

## Hulumtimi në klasë ne rrjetin e internetit

Interneti i plotëson burimet dhe materialet sipas planeve të arsimtarëve dhe nxënësve dhe e zvogëlon pavarësinë nga koha dhe hapësira që janë faktorë kufizues në shkolla. Ai ofron mënyra të fuqishme dhe të llojllojshme për nxënësit dhe arsimtarët në procesine mësimit, mundëson gjetjen e të dhënave të ndryshme dhe krijon mundësi për hulumtim. Interneti është mjet që mund të përdoret thuajse me secilën teori arsimore. Ai i bën të mundshëm edhe burimet plotësuese të informacioneve, e rrit komunikimin dinamik dhe e lehtëson procesin mësimor.

## Kushtet e punës edukativo-arsimore në shkollë

Shkolla jonë ka atmosferë pozitive ,ka identitetin pra karakteristikën e saj fizike dhe psikologjike.
Ambienti shkollor (pamja,rregullimi,oborri i shkollës,terenin sportiv) Shkolla ka zyrën e drejtorit,të sekretarit,të arsimtarëve,klasat ku nxënësit mësojnë,bibliotekën , mirëpo na mungojnë kabinete si dhe mjetet bashkëkohore didaktike. Me programin e ri shkollor kemi edhe klasën të pajisur me kompjutor ku mësohet lënda e informatikës si dhe shkolla e ka rrjetin e internetit.
Gjatë pushimit vjetor është e gëlqeruar shkolla e dizenfektuar për shkak te virusit dhe e ndriçuar.Mësimi zhvillohet në dy ndrrime edhe atë paradite dhe pasdite në të dy shkollat.Sipas kushteve që ka shkolla është e pajisur me mjete mësimore me ato më elementare.

**V**eprimtaria educative arsimore nuk mund të ndërpritet gjatë vitit shkollor përveç gjatë festave shtetërore ,festave të etniteteve, festat fetare dhe gjendjes gjatë situatave të jashtëzakonshme (fatkeqësi natyrore,epidemi ).

Në ditën e patronatit të Shën .Kirili dhe Metodi – 24 Maj,festohet patronati i shkollës , ku organizohen manifestime edukative, kulturore zbavitëse dhe sportive.

Struktura e kuadrit edukativ-arsimor kanë përgaditje profesionale,përvojë,përsosje permanente etj, shkolla jonë ka edhe gjendjen financiare.

## Mësimi plotësues

Në pajtim me Plan-programin mësimor për shkollat fillore shkolla është e obliguar të bëjë përcjelljen permanente dhe sistematike të nxënësve që kanë vështirësi në mësimin e rregullt.
Mësimi plotësues është i përfaqësuar me numër të caktuar të orëve.
Mësimi plotësues organizohet për nxënës të cilët në vazhdimësi tregojnë rezultate të dobëta në mësime ,e veçanarisht nëse:

- Kanë së paku dy nota të dobëta,
- Kanë rezultate të dobëta në lëndë të caktuar mësimore,
- Mungojnë nga mësimi në lëndë të caktuar mësimore dhe –
- Me kërkesë të nxënësit ose prindit ,përkatësisht tutorit të tij.

Mësimi organizohet për nxënës të cilët ballafaqohen me vështirësi në mësim të cilët nuk mund të arrijnë sukses pozitiv ,me ngecje në disa lëndë mësimore,organizohet për nx. me mësim lëndor dhe klasor kanë numrin e nxënësve sipas përparimit të nxënësve.
Mësimi plotësues në këtë vit shkollor organizohet edhe në momente kur nxënësit kanë nota negative pa marrë parasysh se cilën lëndë.

Në këtë lloj mësimi organizohet mësim individual ,në punë grupore dhe më rrallë në formën frontale.
Nxënësi i dërguar në mësim plotësues ,gjatë një muaji ndjek mësim plotësues më së shumti në dy lëndë me më së shumti katër orë mësimore për lëndë mësimore.
Nëse nxënësi nuk i ndjek orët e mësimit plotësues merr mungesë të paarsyeshme.

## Mësimi shtues

Organizohet në pajtim me plan-programin për shkollën fillore ku organizohet dhe ka karakter të detyrueshëm.
Mësimi shtues u dedikohet nxënësve të cilët arrijnë rezultate mbimesatare dhe dallohen me dhunti dhe talent të shquar në lëndët e caktuara mësimore .

Mësimi shtues me nxënës të talentuar ku bëhet identifikimi dhe zgjedhja e nxënësve me përcjellje sistematike,me kontrollim dhe vlerësim të aftësive zhvillimore. Në orët e mësimit shtuese dhe aktiviteteve të ndryshme nxënësit kanë treguar interesim dhe i u jepej një përkrahje e madhe nxënësve që përparojnë më shpejt , pra kjo ishte rezultat dhe sukses i arritjeve të nxënësve tanë që morën pjesë në gara të ndryshme komunale dhe republikane të cilët janë shpërblyer me dhurata të ndryshme lëvdata dhe mirënjohje.

Shkolla ka sistem për identifikim të nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë, si dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vazhdimisht ndjek përparimin e tyre.

**Programe të individualizuara për te punuar me nxenesit e talentuar**

Çdo arsimtar identifikon dhe përgaditë program individual për të punuar me nxënësit e talentuar me kohëzgjatje të realizimit nga muaji Shtator deri në Maj gjatë një viti shkollor në të cilën do të jenë të kyçura lëndët ku nxënësi dotë tregoj talent.
Si persona përgjegjës janë arsimëtarët lëndor dhe klasor në bashkëpunim me shërbimin profesional. Këto planprograme mësimore nënkuptoin nivel më të lartë shhkencor të përmbajtjeve programore.

**Garat e nxënësve**

Garat ndikojnë që te nxënësit të zhvillohet fryma garuese,shoqërimi,si dhe të thellohen të përfitohen njohuri e dituri ne mesime.
Sipas qëndrueshmërisë së tyre ata mund të jenë:shkollore,komunale,rajonale dhe republikane**.**

Garat shkollore organizohen për pjesëmarrësit e klasëve të IV-IX në të gjitha lëndët mësimore ku marrin pjesë të gjithë nxënësit që kanë interes dhe talent.Nxënësit tanë kanë marrë pjesë në shumë gara ku janë lavdëruar dhe shpërblyer si dhe nxënës të gjeneratës të klasës së IX.
Poashtu organizohen edhe kuize të diturisë të lëndëve përkatëse per festat e Marsit e Nentorit.
Nxënësit zhvillojnë shkathtësitë individuale dhe numri më i madh i nxënësve sipas zgjedhjes së vet janë të përfshirë së paku në një aktivitet të lirë për mbështetjen e zhvillimit të tyre personale dhe sociale,pa dallim nga gjinia,përkatësia etnike dhe statusit social. Në orët e mësimit plotësuese ,shtuese dhe aktiviteteve të lira nxënësit kanë treguar interesim dhe i u jepej një përkrahje e madhe nxënësve që përparojnë më shpejt , pra kjo ishte rezultat dhe sukses i arritjeve të nxënësve tanë që morën pjesë në gara të ndryshme.
Në shkollë disa arsimtarë me punën e tyre profesionale në kontinuitet identifikojnë nxënës të talentuar.

## Arsimi dhe edukimi fillor i nxënësve me nevoja të veçanta

Në arsimin dhe edukimin e nx.me nevoja të veçanta arsimore niset nga parimet demokratike ,humanitare për edukim,arsim dhe aftësim për jetë.

- Planifikimi i kësaj veprimtarie në shkollë organizohet vetëm në rastet kur shkolla ka nxënës me pengesa në zhvillim, pengesa në të folur,puna logopedike,puna me fëmijë që kanë pengesa trupore, me pengesa të lehta intelektuale dhe fëmijët që kanë pengesa emocionale etj.Kurse fëmijët me dëmtime më të rënda kyçen në shkollat e veçanta.

Mirëpo në shkollën tone nuk kemi kushte hapsinore dhe mjete adekuate si dhe arsimtar professional për këto fëmi me pengesa të lehta psiko-fizike prandaj shkolla është e obliguar të punojë me këta fëmijë sipas kushteve që i disponon .

## Arsimi inkluziv

(1) Arsimi fillor është organizuar në mënyrë institucionale, kadrovike dhe përmbajtjesore në mënyrë që mbështet inkluzionin e të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt fillor.

(2) Arsimi inkluziv është proces i cili do t’i marrë parasysh nevojat e ndryshme individuale për zhvillim të nxënësve, duke dhënë mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave themelore për zhvillim dhe arsim cilësor.

Nxënësit do të inkuadrohen në të gjitha manifestimet që organizohen.

***Institucione nga fusha e kulturës***

Shkolla do të implementoj komunikim me institucionet nga fusha e kulturës: biblioteka, muze, teatro, kinema etj. Nxënësit do të marrin pjesë në konkurse letrare, do të realizohen vizita të monumenteve kulturore historike, muzeumeve, ekspozitave etj.

***Institucionet nga fusha e arsimit***

Në bashkëpunim me shkollat tjera.
Vizita e nxënësve në disa prej shkollave me shkëmbim ose gjatë realizimit të
ekskursioneve profesionale është aktivitet i planifikuar që deri më tani është realizuar.
Bashkëpunimi i aktiviteteve sportive dhe garave në nivel komunal, rajonal dhe republikan, gjithashtu është një aktivitet i planifikuar për bashkëpunim me shkollat tjera të Republikës.
Ndihma profesionale nga bashkëpunëtorët profesionalë, këshilltarët epavarur pranë BZHA.

Për të gjithë vështirësitë, paqartësitë dhe shqyrtimet, propozimet dhe mendimet, pjesëmarrja në përpilimin e planave dhe programeve mësimorë realizohet bashkëpunimi që edhe deri më tani kemi realizuar dhe planifikuar, edhe këtë vit planifikojmë që të realizojmë këto bashkëpunime me këtë do të kontribuojmë për kultivimin e traditës dhe zhvillimin e programeve të reja mësimore.

***Organizatat joqeveritare***

Shkolla do të bashkëpunojmë me organizatat joqeveritare për realizim të projekteve .

Projektet në fushën e arsimit janë të grupuar sipas këtyre prioriteteve:

Avancimi i të drejtave të nxënësve në suaza të sistemit të shkollave fillore

Avancimi i shëndetit dhe ambientit jetësor.

Edukimi dhe trajnimi i shkollarëve të mesëm për avancim të aftësive dhe diturive nga fusha e oratorisë, sipërmarrësisë, marketingut dhe inovacioneve

Organizimi i manifestimeve, evenimenteve kulturore artistike dhe para për shkollarët e viteve përfundimtare, promovim të s e m i maturantëve më të mirë.

Organizimi i manifestimit përkatës për promovim të maturantëve më të mirë

nga shkollat e mesme të qytetit .

Organizimi i forumeve, punëtorive, garave dhe manifestimeve për pasurim të programeve të aktiviteteve jashtë mësimore dhe avanimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën shkollore.

***Klubet sportive***

Shkolla do të bashkëpunoim me klubet sportive:

Me qëllim të përkujdesjes për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, shkolla do të bashkëpunojë me Shtëpinë e shëndetit – Dispanzerin shkollorë, Institutin për shëndet publik, Organizata e Kryqit të Kuq, Fondin për shëndetësi, Kompanitë e sigurimit të nxënësve. Në bashkëpunim me Institutin për shëndet publik, do të organizohen ligjërata edukative nga fusha e raporteve humane mes gjinive.

**Realizimi i planeve dhe programeve mësimore**:

• Planet dhe programet e aplikuara mësimore

• Informimi i prindërve dhe nxënësve mbi planet dhe programet mësimore

• Adaptimi i programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

• Zgjedhja e lëndëve mësimore

• Realizimi i programeve të zgjeruara

**Cilësia e planeve dhe programeve mësimore:**

• Barazia gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore
• Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore
• Integrimi i qëllimeve të përgjithshme (ndërmjet lëndëve) të arsimit
• Ndikimi i mësimdhënësve dhe prindërve në planet dhe programet mësimor

Në kuadër të mësimit,mësimi i lëndëve të detyrueshme paraqet bazën përmbajtësore të shkollës ku mësohen sipas planit mësimor të sh.f. Gjuhë shqipe,gj. Maqedone ,lëndët natyrore,shoqërore,arsimi fizik e shëndetësor ,ars. figurativ,ars.muzikor,gjuha angleze ,gj.frënge,kultura qytetare dhe informatika.

Të gjitha lëndët janë të përfshira sipas planit mësimor ndërsa qëllimet dhe detyrat si dhe përmbajtjet mësimore janë të përfshira sipas programeve mësomore.Organizimi i mësimit i përfshin edhe këto elemente:

- formimin e paraleleve,caktimin e nxënësve në paralele,bartësit e drejtëpërdrejtë të mësimit,orët mësimore,pajisjen me libra të nxënësve.
- Mësimi në arsimin fillor përveç lëndëve të detyrueshme pasurohet edhe me lëndë zgjedhore dhe me programe për të fituar njohuri rreth shkathtësive jetësore.

**Aktivitetet jashtëmësimore**

Kjo strukturë përfshinë elemente të rëndësishme jo vetëm për organizimin dhe realizimin e programit mësimor,por edhe për afirmimin dhe vetërealizimine nxënësve në segmente e sfera të ndryshme të shkollës,planifikohen sipas madhësisë dhe kushteve ku punon shkolla.

Këtu përfshihen aktivitete dhe përmbajtje të cilët realizohen jashtë dmësimit.

Aktivitetet janë për zgjerim të diturive,të zhvillojnë kurreshjtjen e fëmisë,kreativiteti, pavarësinë,qëndrueshmërinë,aftësitë individuale dhe kultivohet koha e lirë e nxënësit dhe tregohen rezultatet e arritura etj.

• Vëllimi dhe llojllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtë mësimore

• Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtë mësimore

• Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet
jashtë shkollore

• Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës, përmes aktiviteteve jashtë mësimore

Këto aktivitete janë: -Aktivitetet e lira të nxënësve
- Puna e dobishme shoqërore
- Aktivitetet e bashkësive të nxënësve
- Ekskurzsionet
- Garat e nxënësve






Vetë interesimi i nxënësve jep përcaktimin e llojit të aktivitetit. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve krijohen parashikime individuale në procesin edukativo-arsimor për motivimin dhe kujdesin individual të aftësive të nxënësit.

**Aktivitetet e lira**

Vëllimi dhe llojlloshmëria e aktiviteteve jashtë mësimore janë të planifikuara ku ato shprehin nevojat dhe interesimin e nxënësve dhe shërbejnë për mbështetjen e zhvillimit të tyra personal dhe social.
Numri më i madh i nxënësve janë të përfshirë së paku në një aktivitet të lirë për mbështetje të zhvillimit të tyre personal e social pa dallim gjinie,,përkatësia etnike dhe sociale.

Ata përfshihen sipas zgjedhjes së vet, pra nxënësit me ndihmën e arsimtarëve marrin pjesë në manifestime të ndryshme dhe përpiqen të arrijnë sukses të lartë nëpër gara të ndryshme që organizohen në nivel lokal ,shtetëror dhe ndërkombëtar .
Ekzistojnë dhe shfrytëzojnë mjete ( p.sh. radio e shkollës,këndi shkollor etj )për afirmimin e tyre dhe suksesin më cilësor.

Aktivitetet realizohen me nxënësit e grupit klasor dhe lëndor dhe ato ndahen në këto grupe:

Matematikantët e rinj Fizikanët e rinj
Kimistët,biologët,gjeografët,historianët ,piktorët e rinj etj.

Aktivitetet kulturore-arsimore
Kori i shkollës Aktivitet teknike
Seksioni i dramës Aktivitet sportive
Seksioni recitues Seksioni i futbollit,hendbollit,basketbollit
Seksioni letrar
Bibliotekistët

Përcjellja,vlerësimi dhe përparimi i procesit edukativo-arsimor

Notimi si pjesë përbërëse e procesit-edukativo arsimore

**Vlerësimi i nxënësve**

Pasi notimi si proces i nxënësve sipas dispozitave ligjore, rregullores dhe parimeve është pjesë përbërëse e procesit edukativo arsimor , pra shkolla jonë ka kodin e notimit dhe kritere të harmonizuara për vlerësim , sipas kritereve dhe standardeve të notimit ku si proces i vazhdueshëm duhet të jetë i drejtë,transparent dhe objektiv në parim nxënësit dhe prindërit janë sistematikisht të informuar.

Të gjithë arsimtarët gradualisht kanë bërë përcjelljen permanente të diturive ku kanë shfrytëzuar metoda dhe instrumente matëse ( teste, detyra kontrolluese etj).në mënyrë sistematike vlerësuan përparimin e zhvillimit motorik,kognitiv,social emocional dhe kreativitetin e vetënjohurive të nxënësve.

-Llojet e vleresimit dhe kalendari per vleresim

Lëndë për përcjellje, verifikim dhe vlerësim të veprimtarisë edukativo-arsimore do të jenë rezultatet e arritura në ngadhënjimin e përmbajtjeve edukativo-arsimore, shprehit punuese, shkallë të interesimit dhe angazhimit në mësim dhe aftësimi praktik për aplikim të diturive.
Arritje të nxënësve që të vlerësohet me aplikim të strategjive të ndryshme të
vlersimit .
Notimi duhet të jetë shprehje e orvatjeve të nxënësve gjatë orës mësimore si dhe jashta orëve. Për këtë qëllim, mënyrat e notimit duhet të jenë të lloj llojshme edhe atë:
Vlerësimi gojarisht (që bazohet mbi standardet e vlerësimit dhe Taksonomisë së Bllumit)
Vlerësimi me shkrim (përmes testeve objektive)
Vlerësimi formativ (gjatë vetë orës mësimore)
Vlerësimi sumativ (në gjysmë vjetor dhe në fund të vitit)

VLERËSIMI me numra: Përcaktimi notës numerike që duhet të përfshijë arritjet e nxënësit krahas të mbajturit mend dhe reproduktimit të përmbajtjeve mësimore, kuptimit dhe përvetësimit të përmbajtjeve mësimore, përkatësisht aftësive të nxënësit për interpretim të tyre .

Me aftësi më të larta intelektuale për analizë, sinteza dhe vlerësimi, që nënkupton aftësinë e nxënësit për rregullim, kombinim të elementeve në tërësi të reja dhe aftësi të nxënësit për vlerësim të arsyeshëm së ndonjë konstatimi ose vepre.Nota numerike përcaktohet në këtë mënyrë:

Nota e mjaftueshme dy (2) – dituritë nxënësve kanë të bëjnë me të mbajturin në mend dhe reproduktimin, nxënësi duhet të njoh dituritë të ofruara, të definoj, të reproduktorë fakte, të numëroj, të emëroj nocione dhe të zbatoj dituri në detyra më të thjeshta.

Nota mirë tre (3) - dituritë nxënësve kanë të bëjnë me të mbajturin në mend dhe reproduktimin, nxënësi duhet të njoh dituritë të ofruara, nxënësi mund tëanalizoj fakte dhe praktikisht ti zbatoj dituritë, logjikisht të mendoj dhe të ketë mendimin e tij, të numëroj, të emëroj nocione dhe të zbatoj dituri në detyra më të thjeshta.

Nota shumë mirë katër (4) – dituritë e nxënësve kanë të bëjnë me detyra të elementeve të njohura dhe të reja, nxënësi mund të analizoj fakte dhe praktikisht ti zbatoj dituritë, logjikisht të mendoj dhe të ketë mendimin e tij, vazhdimisht të jetë aktiv, të jetë i plotësueshëm, i rregullt në mësime dhe obligime, të interpretoj, të krahasoj dhe ti analizoj dhe ilustroj me shembuj kritik të diturive të përvetësuara.

Nota shkëlqyeshëm pesë (5) – dituritë e nxënësit kanë të bëjnë me analizë, sintezë dhe vlerësim, nxënësi mund të zbatoj dituritë për zgjidhjen e detyrave me elemente të njohura, është i aftë për mendim logjik dhe zbatim praktik të fakteve, ai ka qëndrime të ndërtuara, është i aftë të sistematizoj dhe gjeneralizojë, të hulumtoj dhe zbatoj dituritë, është i aftë për lidhjen e teoris me praktikën, shfrytëzon burime plotësuese, parashtron dhe përgjigjet në pyetje të temave të ndryshme.

***VLERËSIMI ME SHKRIM***

Pas çdo tërësie tematike, verifikohet niveli i diturive përmes testeve objektive (pyetje nga 4 nivelet sipas Taksonomië së Bllumit, pyetje me rrethim, plotësim, me bashkim, me sqarime, me zgjidhje etj.). Për këtë qëllim, fitimi i pikave është në mënyrën vijuese: prej 30% deri më 50% suksesi i realizmit të testit pason nota dy (2), prej 50% deri më 70% pason nota tre (3), prej 70% deri 85% nota katër (4) dhe prej 85% deri 100% nota pesë (5).

VLERËSIM FORMATIV: është një proces që realizohet në vetë orët mësimore, përmes të cilave nxënësit dhe arsimtarët shqyrtojnë shkallën e përvetësimit të materialit, problemeve me të cilat ballafaqohen, çfarë duhet të ndryshohet dhe ku duhet të fokusohen më të tepër për përvetësim më të suksesshëm të materialit mësimor.

VLERËSIMI SUMATIV: Pason si rezultat i të gjitha formave të lartpërmendura të notimit dhe realizohet në fund të gjysmë vjetorit dhe në fund të vitit shkollor.

*Ekipi për përcjellje, analizë dhe përkrahje*

Standardet janë të bazuara në principet e vlerësimit kualitativ dhe të drejtë që janë pjesë e standardeve:

Principet:

1. Vlerësimi, para së gjithash ka për qëllim që ti përmirësoj të arriturat e nxënësve.
2. Vlerësimi siguron informata të plota për suksesin e nxënësve.
3. Vlerësimi është pjesë përbërse e procesit mësimor.
4. Vlerësimi bazohet në përdorimin e më tepër metodave.
5. Vlerësimi është proces i vazhdueshëm
6. Vlerësimi është i drejtë
7. Vlerësimi është transparent

Çdo tremujor prindrit marrin informata në mbledhjet prindërore për suksesin e fëmijve të vetë,gjithashtu janë të informuar edhe me shkrim gjatë gjysëmvjetorit dhe në fund të vitit.

**• Politika e shkollës për notim**

Shkolla i zbaton dispozitat pozitive ligjore që e rregullojnë notimin e nxënësve. Shkolla ka politikë të definuar për notim, qëllimi themelor i së cilës është ta mbështesë mësimin e secilit nxënës, duke përfshirë edhe kodin e notimit. Shkolla ka kritere të harmonizuara për notim, me të cilat nxënësit dhe prindërit janë tërësisht të informuar.

**• Metoda dhe forma të notimit**

Të gjithë mësimdhënësit shfrytëzojnë metoda dhe instrumente të ndryshme për notim dhe në mënyrë të vazhdueshme e ndjekin dhe notojnë zhvillimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në notim (përmes notimit personal, notimit midis veti, ndërtimit të kritereve, mbajtjes së dosjeve). Qasja në notim ju mundëson nxënësve të arrijnë rezultate më të mira.

**• Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim**

Të gjithë mësimdhënësit u japin informata kthyese nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për arritjet dhe përparimin e tyre. Theks i veçantë i vehet vlerësimit të arritjeve aktuale të nxënësve dhe identifikimit të aktiviteteve të ardhshme që do të zbatohen në mësim.

Mësimdhënësit i shfrytëzojnë tërësisht informatat e marra nga notimi që të përmirësojnë planifikimin dhe zbatimin e mësimit.

**Informim për përparimin e nxënësve**

**• Informim i prindërve për përparimin e nxënësve**

Shkolla ka sistem të përcaktuar për informim të prindërve për përparimin fëmijëve të tre dhe e zbaton në mënyrë konsekuente. Sistemi i këtillë përfshin grumbullimin e rregullt të informatave për arritjen e nxënësve dhe dhënien e informatave konkrete transparente kthyese prindërve dhe nxënësve për notat, duke përfshirë edhe rekomandime të hollësishme për përmirësimin e suksesit të secilit nxënës veçanërisht.

Për këtë qëllim shfrytëzohen takime joformale dhe formale, takime individuale dhe grupore me prindërit, të cilat janë organizuar mirë dhe në të cilat jepen informata të qarta. Prindërit marrin edhe raporte me shkrim me informata dhe detale për arritjen e fëmijës së tyre për çdo lëndë mësimore, duke përfshirë edhe informatat për zhvillimin personal dhe social të fëmijës.

Nga prindërit kërkohet që të japin informata kthyese pas raportit, pas të cilit ndërmerren aktivitete në përputhje me pikëpamjet e prindërve në raport me arritjen dhe përparimin e fëmijëve të tyre.

Në shkollën tonë organizohet përcjellja sistematike,vlerësimi dhe përparimi në procesin edukativo-arsimor,ajo përfshinë:

- Planifikimi,programimi dhe përgaditja e drejtorit për udhëheqjen pedagogjike të punës edukative në shkollë.
- Planifikimi dhe përgaditja e arsimtarëve për realizimin e suksesshëm të orëve( planin global,plan-programin mujor,plankospektin,përgaditjen ditore e tjera.
- Planifikimi dhe programi efektiv I punës së pedagogut,psikologut,dhe edukatorit.
- Përcjellja,kontrollimi e notimi I suksesit që kanë arritur arsimtarët e nxënësit në mësim e jashtë mësimit.
- Duke e pasur parasysh rolin dhe përcjelljen në punën educative-arsimore do të anagazhohen gjatë tërë vitit shkollor e kjo do të arrihet me sistematizim,kontiniutet dhe objektivitet.

Sistemi ynë i arsimit ka traditë dhe histori ku në rrugën e vet ka pësuar ndryshime dhe ka nevojë për reformim.

Shkolla si institucion public dhe kulturor-arsimor i shpreh synimet dhe aspiratat përparimtare ku ajo kontribon për afirmimin e saj si subject edukativ-arsimor,kulturor dhe shoqëror.

**Përcjellja,kontrollimi dhe notimi i nxënësve** duhet të jetë i vazhdueshëm,sistematik dhe public.dhe sipas nenit 5 të Rregullores elementet e vlerësimit janë(vëllimi dhe cilësia e diturive,shprehitë e punës,interesi për mësim,aftësimi I nxënësve për zbatimin e diturive.

Përcjellja permanente e notimit ka funkcionin si regulator ,dhe si detyrë të bëhen analizat e rezultateve të arritura.

Me aplikimin e planifikimit të notimit dhe realizimin e saj do ta përmirësojmë kualitetin ,kuantitetin dhe objektivitetin e notimit me të cilin do të ndihmojë në rezultatet të suksesshme në mësim te nxënësit dhe në kualitetin e notimit.

Përmes vendosjes së standardeve për notim,trajnimin e kuadrit mësimor,përgaditjen e materijaleve profesionale, ngritjen e vetëdijes së të gjithëve që janë të inkuadruar në procesin e notimit për përfitimin e notimit kualitativ poashtu lidhjen e notimit intern me atë ekstern e cila realizohet në shkollë.Përfshirjen e arsimtarëve në proektet e USAID/PEP,do ta shfrytëzojmë për ngritjen e diturisë profesionale të arsimtarëve dhe kuadrit udhëheqës.

Që të arrihet qëllimi në procesin e notimit edhe atë zhvillimi në praktikën mësimore ,shkollës është e nevojshme:

- Organizimi i mirë
- Udhëheqja
- Përcjellja
- Vlerësimi
- Analiza

Duke pasur parasysh rrethin në të cilin punon shkolla dhe strukturën shoqërore të nxënësve dhe familjeve të tyre ,me planifikimn e notimit do ta përmirësojmë rregullsinë e nxënësve për mësim dhe interesin e prindërve për arritjet e fëmijëve të tyre

## Qëllimi: Përmirësimi i kontinuitetit ( vazhdimësisë) në notim

| **Detyra Aktivitete** | **Realizues** | **Grupi qëllimor** | **Resurset** | **instrumentet** | **Përcjellja e informacionit** | **Korniza kohore** | **Kriteri i suksesit** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Krijimi, Mbështetja dhe Promovimi I planifikimit Të notimit shkollor | Bashkëpunëtorët profesional | Arsimtarët Këshilli i Prindërve Dhe Nxënësit | Materijale nga Proekti Lgji për arsimin fillor | Evaluimi Çek lista Informacioni | Raportet Proces verbal | Gusht-shtator | Takime të Realizuara Përkrahja e arritur |
| Përcjellja E procesit Të notimit | Drejtori Pedagogu psikologu | Arsimtarët ( Klasor Dhe lëndor) | Planifikimi shkollor I Notimit Planet e Arsimtarëve Dokumentet Dhe focus – grupet E nxënësve | Shënime Anekdotime Çek-listat | Raportet | Në vazhdimësi | Vizita të Realizuara ,hartimi I Raportit Dhe konstatimeve |
| Realizimi I qëndrimit Të arsimtarëve në notim | Drejtori Bashkëpunëtorët Profe. Koordinatorët shkollor | Arsimtarët | Programi shkollor Ligji për A. fillorMaterijla e nga seminaret | Anketimet Intervistat | Raportet Analizat Dhe konstatimet | Tremujorshi I parë | Raportet Konstatimet Për ndrrimin e qëndrimit daj notimit |
| Vlerësimi I kontinuitetit Në notim | Drejtori Bashkëpunëtorët Profe. Koordinatorët shkollor | Arsimtarët | Planifikimi Tematik Plankospektet e arsimtarëve | Portfoloit e arsimtarëve | Informacione Të kthyera | Vazhdimësi | Përmirësimi I notimit |

## Qëllimi: Përmirësimi i kontinuitetit ( vazhdimësisë) në notim

| Detyra Aktivitete | Realizues | Grupi qëllimor | Resurset | instrumentet | Përcjellja e informacionit | Korniza kohore | Kriteri i suksesit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Krijimi, Mbështetja dhe Promovimi I planifikimit Të notimit shkollor | Ekipi I notimi | Arsimtarët Këshilli i Prindërve Dhe Nxënësit | Analiza e gjendjes Plotësimi I ideve Materijale nga Proekti Lgji për arsimin fillor | Anketimet Për arsimtarë Prindë Dhe nxënës Çel lista | Proces verbal | Gusht-2021 | Aprovim i Planit shkollor Të notimit |
| Përcjellja E procesit Të notimit | Drejtori Pedagogu psikologu | Arsimtarët ( Klasor Dhe lëndor) | Planifikimi shkollor I Notimit Planet e Arsimtarëve Dokumentet Dhe focus – grupet E nxënësve | Shënime Anekdotime Çek-listat | Raportet | Në vazhdimësi | Vizita të Realizuara,hartimi I Raportit Dhe konstatimeve |
| Analiza dhe të dhënat E përcjelljes të notimit | Drejtori Bashkëpunëtorët Profe. Koordinatorët shkollor | Arsimtarët | Programi shkollor Ligji për A. fillorMaterijlae nga seminaret | Të dhënat statistikore | Këshilli I prindërve Raportet Analizat Dhe Konstatime | 2022– Janar – qershor | Përmirësim I kontinuitetit Në notim |
| | | | | | | | |

## Ekskurzionet e nxënësve

*„ Udhëtim, Mësim, Rekreim, Shoqërim"*

Sipas Plan-programit, statutit dhe rregullores të shkollës Ekskurzionet organizohen dhe kanë karakter të obligueshëm në procesin mësimor.

Në bazë të nenit 34 me vendimin 4 të Ligjit për arsimin fillor Ministria e arsimit fillor e aprovoi Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskurzioneve si dhe aktivitetet e lira të nxënësve në shkollat fillore.

Lloji i ekskurzioneve shkollore organizohet dhe përcaktohet varësisht nga funksioni,qëllimet dhe detyrat.**Këto** realizohen në kuadër orarit të ditëve mësimore, të cilët duhet ti realizojë shkolla gjatë vitit shkollor.

Ekskurzionet kanë karakter të përgjithshëm edukativo-arsimor,ekskurzione për zbavitje dhe rekreim.

Programi për organizimin dhe realizimin e secilit ekskurzion ka

- Qëllimet dhe detyrat e ekskurzioneve shkollore dhe aktiviteteve të lira.
- Planifikimi, programimi dhe kushtet për organizimin dhe realizimin e ekskurzioneve
- Raporti për realizimin e ekskurzioneve dhe aktiviteteve të lira të tjera.

Në këtë vit shkollor ato realizohen në kornizë në ditët e mësimit të obligueshëm ku ato mbahen në pranverë dhe vjeshtë. Kahja e udhëtimit prej klasës së parë deri të nëntën në Republikën e Maqedonisë Veriore ,kohën e realizimit,vendet ,objektet të cilat vizitohen,udhëheqësin dhe mjetet financiare etj.

Angazhimi i prindërve mund të kontribojë shumë në organizimin e ekskurzioneve. Ato organizohen për zgjerimin dhe thellimin e diturive ,edukimin e nxënësve si dhe sport,rekreim , argëtim
si dhe lloje të aktiviteteve ndryshme pedagogjike të planifikimit të kohës së lirë të nxënësve.

Shkolla i organizon ekskurzionet e nxënësve ku do të realizohen – - nxënësit prej

- Nxënësit klasës së tretë – njëditëshe
- nxënësit e klasë së gjashtë – dy ditëshe
- nxënësit e klasës e IX – tri ditëshe

Me angazhimin e arsimtarëve dhe në bashkëpunimin e prindërve nxënësit janë të përkrahur nga ata të cilët nxënësit

me shkresë marrin pëlqimin e prindërit dhe ndihma e tyre është e pazevendësueshme.

Numri i ekskurzioneve gjatë vitit shkollor , programet për realizimin e tyre , mënyra e organizimit dhe realizimit vërtetohen me plan programin vjetor të punës së shkollës si dhe planifikimin global në lëndët mësimore
Arsimtarët përgjegjës: Xhemile Saiti,Svetlana Stojanoviq,Sulejman Xheladini

| **Aktivitetet e planifikuara** | **realizator** | **koha e realizimit** | **pjesëmarrësit-nxënësit arsimtarët** | **qëllimi** | **metodat dhe udhëzimet e realizimit** |
|---|---|---|---|---|---|
| Shëtitje vjeshtore një ditëshe në mjedisin e shkollës | Ekipi i shkollës | Shtator apo tetor | Nxënësit e kl.3 - 9 | Krijimi i shkathtësive edukative arsimore | Vetëdije më e lartë Për mbrojtjen a ambientit ,njohja dhe dituri të thella per natyren |
| Organizimi I shkolles dimërore | Ekipi i shkollës | janar | Nxënësit e kl.3 - 9 | Krijimi i dobive edukative Arsimore kreative | Vetëdije më e lartë Për mbrojtjen a ambientit ,njohja me bukuritë natyrore |
| Ekskurzioni dyditore në Maqedoninë perëndimore | Ekipi i shkollës | Tetor apo maj | Nxënësit e kl.6 | Krijimi i shkathtësive edukative Arsimore kreative | Zgjerimi i diturive Te pasurive kulturo historike dhe vetëdijes ekologjike |
| Ekskurzioni tri ditore në Maqedoninë perëndimore | Ekipi i shkollës | Tetor apo maj | Nxënësit e kl.8 | Krijimi i shkathtësive, njohurive diturive, edukative Arsimore e kreative | Zgjerimi i diturive Te pasurive kulturo historike dhe vetëdijes ekologjike Rekreim zbavitje shoqerim etj. |
| Mësimi në natyrë në Maqedoninë perëndimore | Kujdestarët E klasës | Maj | Nxënësit e kl.4 | Bashkëveprimi I teorisë dhe praktikës Dobitë edukativo arsimore | Zgjerimi i diturive<br><br>Rekreim zbavitje shoqerim etj. |
| Ekskurzion njëditësh , Pelinc Saraj,rtj. | Ekipi i shkollës | Prill maj | Nxënësit e kl.1-2-8 | Krijimi i shkathtësive, njohurive diturive, edukative Arsimore e kreative | Zgjerimi i diturive ,sjellja ndaj natyrës Rekreim zbavitje shoqerim etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Organizimi i pushimit veror | Ekipi i shkollës | Qershor,korrik | Nxënësit e kl.1--9 | Krijimi i shkathtësive, njohurive diturive. | Zgjerimi i diturive ,sjellja ndaj natyrës Rekreim,shëndet zbavitje shoqerimetj |

## Puna e dobishme shoqërore dhe humanitare të nxënësve

Ka për qëllim që të zhvillohet dashuria ndaj punës,ndjenjën e përgjegjësisë,
Shprehive për mbajtjen e higjienës në shkollë dhe rrethinë, të krijohet respekt
dhe qasje pozitive ndaj monumenteve kulturore-historike.

1. Mirëmbajtja dhe rregullimi i ndërtesës së shkollës dhe oborrit të shkollës
2. Mirëmbajtja dhe rregullimi i monumenteve kulturo-historike
3. Organizimi i aksioneve ekologjike të nxënësve
4. Pyllëzimi i vendeve të zhveshura në rrethinën e shkollës

Kështu do të ndikohet në zhvillimin e lartë edukativo-arsimore

**Aktivitetet e bashkësive të** nxënësve kanë për qëllim ti përforcojë dhe zhvillojë pavarësinë e nxënësve,disiplinën e tyre,përgjegjësinë për punë dhe sukses në shkollë ti përgaditë nx. si qytetarë në shoqërinë demokratike.
Secila nga këto bashkësi duhet të përgaditë program të saj në përputhshmëri me moshën dhe interesat e nxënësve.

Shkolla ka dispozita të shkruara për sigurimin e mjeteve materiale për nxënësit të cilët, për shkak të familjeve të tyre me gjendje të vështirë materiale, nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin me të njejtat kushte si edhe nxënësit e tjerë (për shembull, për shkak të mospasjes së librave shkollorë dhe mjeteve mësimore) dhe të marrin pjesë në aktivitetet e lira të cilat kërkojnë mjete plotësuese (për shembull, ekskurzione, shfaqje dhe gara). Dispozitat zbatohen në praktikë për të gjithë nxënësit që rrjedhin nga familje me të ardhura të ulta materiale. Me këtë rast, shkolla bashkëpunon me prindërit, bashkësinë lokale dhe me institucione të tjera relevante (për shembull,

qendra për punë sociale, organizata humanitare dhe bashkësi afariste).

Aktivat profesionale rregullisht mbajnë takime në të cilat diskutojnë dhe shkëmbejnë përvoja dhe mendime. Gjithashtu vizitojnë realizojnë vizita të ndërsjella. Përskaj shkëmbimit të përvojave profesionale, bashkëpunimit ekipor, shumë i rëndësishëm është edhe zhvillimi produktiv për komunikim të hapur, respektimi dhe besimi i ndërsjellë, zgjidhja konstruktive e situatave problematike.

*Puna ekipore dhe klima shkollore*

Bashkëpunimi dhe respekti i ndërsjellë lujn rolin kryesor në funksionalizimin e shkollës. Komunikim i hapur,respekti i medimeve,modestia dhe vetëkritika.
Zhvillim profesional i kuadrit mësimor dhe realizimi i programeve të reja janë si rezultat I arritjeve të reja shkencore, ndryshimeve shoqerore , programeve të reja mësimore.Të gjitha aktivitetet do të realizohen gjatë vitit shkollor dhe ne bashkeppunim me të gjitha strukturat e shkolës dhe jashtë saj, që janë të lidhura me shkollën.

Zhvillimi profesional i kuadrit arsimor

Zhvillimi profesional i kuadrit arsimor bën pjesë në prioritetet e shkollës.
Në atë drejtim shkolla kujdeset për zhvillim profesional në të cilën janë të kyçur të gjithë arsimëtarët dhe shërbimi profesional.
Zhvillim profesional nënkupton professionalizim individual,zhvillim intern(nga shkolla) si dhe ekstern (nga BZHA dhe Ministria e arsimit).

**Programi për zhvillim profesional të kuadrit arsimor**

| Aktivitete për zhvillimin profesional të kuadrit | Bartës/bashkëpuntor |
|---|---|
| Pjesmarrja në punët e aktiveve profesionale | arsimtarët,pedagogu, |
| Këshillat e klasave | drejtori, arsimtarët, |
| Këshilli i arsimëtarëve | pedagogu,drejtori, psikologu |
| Pjesmarrja në seminare,këshillime,konsulltime | arsimtarët,pedagogu,drejtori, |
| Ndihmë profesionale arsimëtarve fillestar | BZHA. |
| Shfrytzim i literaturës profesionale dhe Pedagogjike | arsimtarët,pedagogu,drejtori, |

***Detektimi i nevojave dhe prioriteteve***

Një prej prioriteteve që pasojnë nga gjendjet e detektuara nga vetë evalvimi është nevoja për zhvillim profesional të arsimtarëve,dmth arsimtarët dhe shërbimi profesional dotë vizitoin sa më tepër seminare me qëllim profesionaizimin e kuadrit gjatë v.sh.2022/2023.

***Aktivitete për zhvillim profesional***

Në planin zhvillimor të shkollës, një prej qëllimeve zhvillimore është edhe përsosja profesionale e arsimtarëve.

Qëllimi dhe detyrat:
Motivim i arsimtarëve për zhvillim të vazhdueshm profesional me qëllim arritje të rezulltateve më të larta në punë. Shtojca – tabela e planit zhvillimor.

| Aktivitete | Bartës/realzues | Bartës/realzues | Kriteret e suksessit |
|---|---|---|---|
| Detektimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim prof.të kuadrit arsimor | Arsimtarët,pedaagogu, drejtori, | Në fillim të viit shkollor | Plan i përgaditur për nevojat,riteret dhe parametrat për përcjellje të mëtutjeshme |
| Përcjellja e aktiviteteve gjatë orës mësimore | Arsimtarët,pedaagogu, drejtori, | Në fillim të viit shkollor | Procedura dhe programe të definuara për përcjellje të orëve mësimore.istrumente për përcjellje. |
| Përcjellja e portofoliove profesionale të arsimtarëve | Arsimtarët,pedagogu, drejtori, | Gjatë vitit shkollor | Çertifkatat,punimetpla net etj. |

***Zhvillimi profesional***

Çdo arsimtarë në mënyrë individuale dhe kolektive, profesionalisht përsoset. Indivivualisht përmes përcjelljes së literaturës profesionale dhe kolektivisht përmes seminareve dhe trajnimeve.
Për zhvillimin e tij profesional drejtohet portofolit

## Përcjellje,vlersim dhe përparim i kuadrit edukativo arsimor

| Qëllimi | Përmbajtjae aktiviteteve | realizues | Efektet e pritura |
|---|---|---|---|
| Pregaditja e programeve kualitative | Njohja me programe të reja mësimore,udhëzime,libra. | Arsimtar,pedagog, prindër,drejtor, | Përparimi i procesit edukativë dhe përcjellja e ndryshimeve |
| Ballafaqimi me lëshimet dhe gabimet në planfikim dhe evitimi i tyre. | Analiza e planifikimeve globale,tematike dhe ditore | aktivi profesional, pedagog,,drejtor | Programe kualitative që dotë kontribojn në zhvillim të punës së gjithanshme të shkollës. |
| Vendosja e qëllimit të qartë gjatë orës dhe Aktivitete konkrete | Përcjellja dhe vlersimi i orës mësimore | Arsimtar,pedagog, prindër,drejtor, | Realizim i qëllimeve të planifikuara me përdorm të formave dhe metodave përkatëse, përdorim efikas i shkollës |
| Përcjellje permanente e njohurive,aftësiv e dhe të arriturat e nxënësve. | Përcjellja ,kontrollimi dhe vlersimi i të arriturave të nxënësve nëpërmjet vëzhgimit,vlersiit gojor,detyrave të shtëpisë dhe testeve objektive. | Arsimtar,pedagog, prindër,drejtor, | Arritjee mësiit interesant dhe vlersimit objektiv<br>-standarde dhe kriteriume për vlerësim |
| Zbulimi në kohë i aftësive,mundësive dhe interesit të nxënësve. | Përcjellje e realizimit të mësimit plotësues dhe shtues. | Arsimtar,pedagog, prindër,drejtor, | Përparim i nxënësve sipas aftësive të tyre dhe nxitje e zhvillimit të tyre individual dhe emocional |

***Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë professional***

Zhvillimi profesional përfshin trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e suksesshëm të planprogrameve të reja mësimore.

Shkolla do të kujdeset për zhvillimin profesional e të gjithë mësimdhënësve dhe shërbimit profesional. Në varëshmëri të nevojave do të organizohen desiminime të brendshme dhe gjithashtu do të marrin pjesë në të gjitha trajnimet, seminaret dhe këshillimet të organizuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucione të tjera.Stafi mësimdhënës është i detyruar të marrë pjesë në seminare dhe konsultime.Në kuadër të shkollës zhvillimi profesional do të jetë në përputhje me prioritetet e programit vjetor të punës së shkollës, programet e punës të aktiveve profesionale dhe këshillit të arsimtarëve,programi për punë i drejtorit , programi për punë i shërbimit pedagogjik.

**Planet e veprimit (evaulimit) te planeve aksionare**

- *Kriteret për Suksesin*

*Qëllimi strategjik:*

Rritja dhe përmirësimi i kushteve të punës në shkollë

Në mënyrë që të rriten dhe të përmirësohen kushtet në shkollën tonë me planet e veprimit janë përpunuar 4 qëllime strategjike dhe 19 qëllime zhvillimore . Me të njejtat dotë rritet kualiteti i funksionalizimit në shkollë.Instrumentet që do të përdoren në evaulimin e qëllimeve strategjike dhe zhvillimore janë:
vëzhgimi , intervista dhe pyetësor.
*Qëllimi zhvillimor 1 – Rritja dhe përmirësimi i kushteve për punë.*
*Përmirësimi i kapaciteteve hapësinore (rinovimi shkollës, sanimi dhe rregullimi i nyjeve sanitare ),*
*Ndërtimi i terrenit sportiv në oborrin e shkollës*
*sanimi dhe rregullimi i nyjeve sanitare*
*Funksionimi i internetit në shkollë*
*Lyerje dhe përmirësim të mureve të brendshme*
*Lyerje të objekteve*

*Qëllimi zhvillimor*

*- Rritja e cilësisë së mësimdhënies që nxënësit e fitojnë në shkollën fillore përmes përdorimit të mjeteve moderne të mësimdhënies*

Qëllimet zhvillimore detyra

Forcimi i kapaciteteve të mësuesve në modernizimin e mësimdhënies përmes përdorimit të metodave aktive të punës

Mësuesit të përdorin forma moderne të teknikave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të cilat do të rrisin motivimin e nxënësve dhe dotë përmirësojn rezultatet e tyre.

**Furnizim me mjete didaktiko - mësimore për arsimtarët dhe per bashkëpunëtorët profesional**

*Formimi i kabineteve*

*Qëllimi zhvillimor –Zhvillimi profesional i kuadrit mësimor në përputhje me trendet bashkokohore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.*

Trajnimi i Mësuesve për të përdorur e-burime në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies Trajnime për përgatitjen e projekteve.

**Qëllimi Zhvillimor** -Rritja e ndërgjegjësimit të ruajtjes së mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të punës në shkollë .

Te aplikohet ne planifikimin e integruar në kuadër të mësimit brenda aktiveve profesionale, duke e vendosur theksin në krijimin e vetëdijes te nxënësit për mbrojtjen e mjedisit.
Të vendosen kantonier për mbeturina në oborrin e shkollës
Të organizohen aksione për rregullimin e oborrit të shkollës

### *-Instrumentetet mësimore*

Instrumentetet që do të përdoren  në evaulimin e planeve të veprimit janë: vëzhgimi , intervista dhe pyetësor. Si mjet për vlerësimin e ndikimit të çdo qëllimi strategjik mundet të përdoret tabela e mëposhtme:

| **Kriteret** | **Definicioni** | **Lista kontrolluese e pyetjeve që do të shqyrtohen** |
|---|---|---|
| Efektshmëri | Shkalla e arritjes së objektivave dhe ndikimi te programi / projekt për | Përparim drejtë arritjes së objektivave dhe arritjet kryesore. Arsyet nga dhe natyra e ndryshimeve. Faktorë të brendshëm dhe / ose të jashtëm që ndikojn (pozitiv apo negativ |
| Efikasiteti dhe ekonomia | Përdorimi i burimeve të shpërndara | Rezultatet e planeve të veprimit të krahasuara me shpenzimet e duhura. |
| Ndikimi | Përmirësim i punës së përgjithshme në shkollë. | Ndikim nga programi / Projekti për gjendjen e shkollës, mësimdhënësve, nxënësve dhe vetëdijes për rruajtjen e mjedisit jetësorë. |
| Qëndrueshmëria | Jetëgjatësia e ndikimit pas Mbarimit të ndërhyrjes | Masat që përfshihen në planet e veprimit me që të sigurohet qëndrueshmëri pas mbarimit të projektit / programi |

Prindërit përmes Këshillit të prindërve dhe anëtarëve nga radhët e Këshillit të shkollës, që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha segmentet e jetës dhe punës në shkollë.
Këshilli i prindërve pranë Shfk„Kirili dhe Metodij„f. Rramanli i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me jetën dhe punën në shkollë, suksesin, sjelljen dhe rregullsinë e nxënësve si dhe të jap mendime për përmirësimin e tyre.

Këshilli i prindërve, kujdeset edhe për sigurimin e mjeteve monetare dhe materiale përmes llojeve të ndryshme të sponsorimeve, për modernizim të procesit mësimorë dhe realizimin e ekskuzioneve, shpërblimin e nxënësve, përkatësisht për përmirësimin e përgjithshëm të kushteve të punës
Këshilli i prindërve kujdeset për sigurimin e mjeteve për nxënësit që janë me probleme sociale si dhe për punë të tjera që janë në interes për shkollën dhe për nxënësit.
Në procesin mësimor, prindërit japin mendime dhe sygjerime për plotësim dhe sygjerim të çdo plani dhe çdo herë janë të informuar për procesin edukativo arsimor me bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtorin,këshillin e shkollës.pedagogun etj.

***Në aktivitetet e shkollës***

Prindërit i përkrahin dhe janë aktiv në realizimin e aktiviteteve të lira të nxënësve, garave, ekskurzioneve, manifestimeve etj.
*Në sjelljen e vendimeve*
Prindërit janë të kyçur në dhënien e ideve,sjelljen e vendimeve në mbledhjet prindërore,këshillin e shkollës etj..

*Edukim të famijes*
Gjatë vitit shkollor planifikohen dhe organizohen mbledhje me karakter edukativ,vizita të familjeve.

*Përpilim i broshurës për prindërit*
Përpilohet broshurë në fillim të vitit shkollor për prindërit me an të së cilës prezantohen pjesë të programës vjetore të shkollës,me qëllim që prindërit sa më tepër të jenë të informuar për punën në shkollë.

***Komunikimi me opinionin dhe promovimi i shkollës***

*Bashkësia lokale*

Bashkëpunimi me partnerët social realizohet përmes ndihmës së ndërsjellë profesionale, me pajisje gjatë realizimit të projekteve të vogla shkollore, shfrytëzimin e mjeteve demonstruese dhe veglave, pranimi i nxënësve gjatë realizimit të ekskursioneve të planifikuara profesionale, vizitave, me ndërmarrjet, institucionet sociale, institucionet e administratës publike.

Do të realizojmë bashkëpunim me organizatat, kompanitë e ndryshme. Nxënësit do të inkuadrohen në të gjitha manifestimet që organizohen.

*Institucione nga fusha e kulturës*

Shkolla do të implementoj komunikim me institucionet nga fusha e kulturës: biblioteka, muze, teatro, kinema etj. Nxënësit do të marrin pjesë në konkurse letrare, do të realizohen vizita të monumenteve kulturore historike, muzeumeve, ekspozitave etj.

*Institucionet nga fusha e arsimit*

Në bashkëpunim me shkollat tjera.

Vizita e nxënësve në disa prej shkollave me shkëmbim ose gjatë realizimit të

ekskursioneve profesionale është aktivitet i planifikuar që deri më tani është realizuar.

Bashkëpunimi i aktiviteteve sportive dhe garave në nivel komunal, rajonal dhe republikan, gjithashtu është një aktivitet i planifikuar për bashkëpunim me shkollat tjera të Republikës.

Ndihma profesionale nga bashkëpunëtorët profesionalë, këshilltarët epavarur pranë BZHA. Për të gjithë vështirësitë, paqartësitë dhe shqyrtimet, propozimet dhe mendimet, pjesëmarrja në përpilimin e planave dhe programeve mësimorë realizohet bashkëpunimi që edhe deri më tani kemi realizuar dhe planifikuar, edhe këtë vit planifikojmë që të realizojmë këto bashkëpunime me këtë do të kontribuojmë për kultivimin e traditës dhe zhvillimin e programeve të reja mësimore.

***Organizatat joqeveritare***

Shkolla do të bashkëpunojmë me organizatat joqeveritare për realizim të projekteve të tyre.

Projektet në fushën e arsimit janë të grupuar sipas këtyre prioriteteve:
Avancimi i të drejtave të nxënësve në suaza të sistemit të shkollave fillore
Avancimi i shëndetit dhe ambientit jetësor.
Edukimi dhe trajnimi i shkollarëve të mesëm për avancim të aftësive dhe diturive nga fusha e oratorisë, sipërmarrësisë, marketingut dhe inovacioneve
Organizimi i manifestimeve, evenimenteve kulturore artistike dhe para për shkollarët e viteve përfundimtare, promovim të s e m i maturantëve më të mirë.

Organizimi i forumeve, punëtorive, garave dhe manifestimeve për pasurim të programeve të aktiviteteve jashtë mësimore dhe avanimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën shkollore.

## *Fusha te ndryshimeve, prioriteteve dhe qellimeve*

*Fushat e ndryshimit*

Në bazë të raportit vjetor,të analizave të realizuara në shkollë për v.sh.2021–2022 që u bazua në përcjelljen, analizimin dhe vlerësiimin e punës dhe përcaktimi i anëve të fuqishme dhe të dobëta në shkollë,të përcaktuara janë prioritetet vijuese në të cilat është vënë theksi në punën në periudhën vijuese.

- Krijimit të kushteve më të mira për mësimin e AFSH-së ( terren sportiv,rrjeta,mjete sportive), në Mësimin e gjuhëve të huaja si anglisht, frëngjisht,gjermanisht ,të sigurohen mjetet e nevojshme si fjalorë, revista, CD, etj.Barazia dhe drejtësia për të gjithë në shkollë si për nxënësit ashtu edhe për të punësuarit.

- Edukimi i kuadrit për respekt më të madh të parimeve të tolerancës dhe humanizmit në komunikim, si kusht për forcimin e klimës së shkollës
- Ndërtimi te nxënësit sistemin pozitiv të vlerave respektin dhe tolerancën

- Intensifikim të bashkëpunimit me shkollat e tjera në vend dhe jashtë vendit.
- Inkuadrimi i prindërve në përmirësimin e arritjeve të nxënësve në gjithë procesin edukativo – arsimor.

- Zbatimi i metodave interaktive dhe TIK në procesin arsimorë me qëllim që të përmirësohet ambienti i mësimit që nxënësit duhet ta përjetojnë si ambient motivues kurse mënyra e mësimit më interesant;

# Detyrat prioritare

*Detyrat prioritare gjatë vitit shkollor 2022/2023 do të jenë:*

1. Kyçja në projekte të reja ( përmirësimi i kushteve të punës , hapsirave shkollore, kabineteve bashkekohore ).

2. Rritja e cilësisë së procesit edukativo arsimore, zvoglimi I numrit të mungesave të nxënësve në procesin mësimor

3. Kyçja e kanalizimit prej toaleteve e gjeri te gypi kryesor në rrugë.

4. Rrënimi i objektit të vjeter shkollor se kanoset rreziku për nxënësit.

5. Ndërtimi i sallës Sportive nga Ministria e Arsimit ku jemi të kyçur në listë edhe e kemi lejen prej Ministrise.

6. Rrethimi i oborrit të shkollës periferike në f. Agino sell.

7. Ndrrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën periferike
8. Në shkollën qëndrore rregullimi i oborrit , rekonstruimi e shkallëve të hyrjes së shkollës, gjelbërimi i oborrit etj,
9. Intensifikimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve përmes seminareve, konsulltimeve, këshillimeve,punëtorive etj ku përvojat dhe njohurit e këtyre formave të zhvillimit do të përcillen te të punësuarit në shkollë.
10 .Organizimin e garave shkollore te shumica e lëndëve mësimore me qëllim zbulimin dhe përcjelljen e nxënësve të talentuar si dhe praninë dhe pjesëmarrjen e prindërve në të gjitha aktivitetet e shkollës.

***Qëllimet e shkollës***

- Rritja e nivelit dhe mesatares së suksesit të nxënësve

- Ulja e numrit të mungesave

- Zhvillimin e motivimit më të madh te nxënësit që të angazhohen në aktivitete të ndryshme të nxënësve në secilën lëndë,

- Zhvillim të nxënësve të talentuar në atë fushë që ato më shumë i tërheq ,

 Vendosja e procesit edukativo-arsimor në parimet e mësimdhënies moderne,
 Thellimi dhe zgjerimi i njohurive të nxënësve në funksion të zbatimit praktikë të tjere.

 Nxënësit të marrin njohuri, të zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre të nevojshme

 për arsimim të mëtutjeshëm.

 Sigurimi i arritjeve dhe suksesit të lartë.

 Rritja e motivimit te nxënësit dhe mësimdhënësit,

 Rritja e bashkëpunimit dhe mbështetja me mjedisin lokal,

 Ndërtimi i sistemit të vlerësimit , me mënyrat e qarta , precize dhe mjeteve të vlerësimit.

**Kujdesi i shkollës për mbrojtjen shëndetësore të nxënësve**

**Mbështetja e nxënësve**
**Kujdesi i gjithëmbarshëm i nxënësve**

**• Mbrojtje nga lëndime fizike dhe fatkeqësi elementare**
Hapësira shkollore është e sigurtë për zhvillimin e mësimit. Shkolla ka rregullore të përcaktuara dhe aktivitete për sigurimin e
nxënësve gjatë mësimit në ndërtesën shkollore dhe në oborrin shkollor dhe këto i realizon sipas planifikimit. Nxënësit shfrytëzojnë pajime mbrojtëse gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore për arritjen e shkathtësive praktike.
Shkolla ka kuadër të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, në raste fatkeqësie të nxënësve në shkollë dhe i trajnon të gjithë mësimdhënësit që të dijnë të gjinden në këto situata. Shkolla ka akte interne për veprim në raste të fatkeqësive elementare dhe së paku një herë në vit simulon gjendje të tilla.

## *Siguria në shkollë*

Të gjitha subjektet e inkuadruara në procesin edukativo arsimorë në shkollë duhet të ndjehen të sigurtë që të munden me sukses të realizojnë punën e tyre.
Edhe prindërit duan që fëmijë e tyre shkollën ta përjetojnë si një ambient të sigurtë dhe të ndjehen këndshëm.

**Projekti "SHKOLLAT E SIGURTA - AMBIENTE TË HARMONIZUARA"**

Detyra: Ndërtimi i sigurisë në shkollat përmes organizimit, krijimit dhe implementimit të aktiviteteve për ngritje të vetëdijes, aktivitete dhe qëllime të fokusuara drejtë zvogëlimit të nivelit të dhunës dhe sjelljes asociale të rinisë.
Grupi i punës
- krijimi, zhvillimi de implementimi i masave dhe aktiviteteve për identifikim të problemeve;

- Zhvillimi i aktiviteteve / planeve aksionare që do të dizajnohen për ballafaqim përmes identifikimit të problemeve specifike të sigurisë;
- Zhvillimi i strategjive të parandalimit, përkatësisht identifikimi dhe ballafaqimi me problemet e reja të sigurisë në shkollë (ndeshje ndëretnike, shkrimi i grafiteve në muret e shkollës, droga, frikësimi, shkatërrimi i mobileve etj).

Aktivitete të grupit do të jenë:
- Zhvillimi dhe implementimi i raporteve multi kulturore
- Projekte që kanë të bëjnë me kulturën civile.
- Kultura urbane
- Organizimi i edukimit të moshatarëve
- Fushata që do të promovojnë vlerat pozitive mes rinisë përkundër sjelljes asociale dhe të dhunshme

Implementimi dhe promovimi i kodit të sjelljes
Pas përfundimit të hulumtimit dhe analizës dhe pas përpilimit të kodit të sjelljes, do të përpilohet plani vjetor i shkollës për siguri – do të sigurohen zgjidhjet për problemet e identifikuara nga fusha e sigurisë së shkollave deri në fund të vitit
Në shkollë do të realizohen aksione dhe fushata në pajtim me aktivitetet e parapara në planin e aktiviteteve dhe vazhdimisht sipas nevojave të shkollës dhe ambientit.

**• Preventivë ndaj dhunës**
Shkolla posedon një dokument të shkruar në të cilin janë të definuara të gjitha format e sjelljes së nxënësve dhe të rriturve, të cilat llogariten dhunë fizike dhe psikike, me theks të veçantë të formave të shqetësimit.

***Programi preventiv kunder dhunes***

Qëllimi i këtij programi është pengimi i sjelljes së dhunshme në shkollë dhe edukimi i nxënësve për zgjidhje të pa dhunshme të konflikteve.
Dotë realizohet vizita të stacionit policor në Kumanovë ,me qëllm që nxënësit të informohen për mënyrën e veprimit të policëve në raste të caktuara dhe mjetet që përdorin ato.
Realizimi i kontakteve mes shkollës dhe stacionit policor për zgjedhjen e konflikteve.etj.
Zhvillimi i ligjeratave nga eprorët policor me tema:
Prdorimi i alkoholit,i mjeteve narkotike,siguria në shkollë,sjellja në komunikacon etj.

Qëllimi i këtij programi është zvogëlimi i keqpërdorimit të mjeteve narkotike dhe edukimit të nxënësve përmes përmbajtjeve nga lëndët mësimore për dëmet e keqpërdorimi të këtyre mjeteve. Përmes inkuadrimit në aktivitete dhe projekte të ndryshme, nxënësit i ndërtojnë dhe preferojë stilet e shëndosha të jetës.
Shkolla do të bashkëpunojnë me Qendrën për punë sociale, për delikuencë të adoleshentëve dhe organizatat joqeveritare, me qëllim të ofrimit të ndihmës për nxënësit që manifestojnë sjellje asociale. Këta nxënës do të inkuadrohen në projekte dhe aktivitete të ndryshme.

**• Mbrojtje nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës**

Shkolla ka politikën e ndalimit të konsumimit të duhanit, alkoolit dhe distribuimit dhe konsumimit të substancave narkotike, gjë që nënkupton se në shkollë (nëpër klasa, nëpër zyra, tualete, në oborrin shkollor) nuk pihet duhan, nuk vihet në gjendje të\ dehur dhe nuk konsumohet alkool, si dhe nuk distribuohet dhe nuk shfrytëzohen substanca narkotike.
Në bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe me komunën, shkolla gjen mënyrë që ta pengojë përdorimin e alkoolit dhe substancave narkotike në oborrin e vet. Shkolla ka dispozita të shkruara për regjistrimin e dukurive të këtilla dhe ndërmerr masa kur ato nuk respektohen.

**• Cilësia e ushqimit që përdoret**
**• Mbështetja e nxënësve me të meta psiko fizike**

Shkolla ka dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve me të meta psiko fizike në zhvillim. Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe institucione të tjera relevante (për shembull, organizata joqeveritare) për sigurimin e kujdesit të fëmijëve me të meta psiko-fizike në zhvillim dhe posedon mekanizma moderne për nxitjen e bashkënxënësve që të japin ndihmë dhe të kujdesen për ata fëmijë.

**• Kujdesi për nxënësit në familje me gjendje të vështirë sociale**

Shkolla ka dispozita të shkruara për sigurimin e mjeteve materiale për nxënësit të cilët, për shkak të familjeve të tyre me gjendje të vështirë materiale, nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin me të njejtat kushte si edhe nxënësit e tjerë (për shembull, për shkak të mospasjes së librave shkollorë dhe mjeteve mësimore) dhe të marrin pjesë në aktivitetet e lira të cilat
kërkojnë mjete plotësuese (për shembull, ekskurzione, shfaqje dhe gara).

**Shëndeti**

**• Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet**
**• Kujdes për nxënësit me probleme shëndetësore**

**.Kujdesi për shëndetin**

***Higjiena në shkollë***

Kujdesi i posaçëm do ti kushtohet mirmbajtes së higjienës në shkollë. Rregullisht do të pastrohen hapësirat shkollore dhe oborri i shkollës, do të organizohen edhe aksione në të cilat do të inkuadrohen nxënësit me qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënëve kujdesin ndaj vetes dhe rrethit.

***Kontrollimet sistematike***

Të gjithë nxënësit e vitit të parë dhe të viteve përfundimtare do të përfshihen në kontrollimet sistematike që do të realizohen me marrëveshje me mjekun e ambulantës shkollorë. Nxënësit do të përcillen nga kujdestarët e klasës ose personi i shërbimit profesional.

**VAKSINIMI I NXËNËSVE**

Me kalendarin për imunizim dhe vaksinimi do të realizohet për të gjithë nxënësit e viteve përfundimtare. Vaksinimi realizohet nga Dispanzeri shkollor, kurse nxënësit do të përcillen nga kujdestari i klasës.

***Edukimi për ushqim të shëndoshë***

Në suaza të orëve të kujdestarisë dhe gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore, nxënësit do të njoftohen me mënrat e ushqimit të shëndoshë. Gjithashti në mënyrë aktive do të marrim pjesë në fushatën "Ushqimi i shëndoshë për fëmijët pa të meta" me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe përgjegjësive për shëndetin e tyre, duhe shënuar me këtë ditën ndërkombëtare të ushqimit .

**Ndihma këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve**

• Dhënia e ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm,në shkollë të mesme.

Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta, të sakta dhe më të reja për mundësitë e shkollim të mëtejshëm, Për këtë qëllim organizon aktivitete dhe shfrytëzon material promovues të institucioneve arsimore (fletushka, tribuna, vizita nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë etj) për orientim profesional të nxënësve.

Përgaditja që e organizon shkolla për nxënësit për zgjedhjen e arsimimit të mëtejshëm, pas mbarimit të shkollës fillore përmban një spektër të gjerë të qasjeve mirë të strukturuara: për shembull, vlerësim personal i shkathtësive dhe interesave të nxënësve, ndihmë përgatitje për intervistë informim i rregullt i prindërve dhe i nxënësve për ndihmën që mund ta marrin në shkollë, përmes njoftimeve të shkruara dhe gojore nga ana e shërbimit profesionale

**• Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale**

Shkolla ka procedura të shkruara që të zbulojë me kohë dhe të kujdeset për nxënësit me probleme emocionale, pa dallim nga burimet e këtyre problemeve (për shembull, dhunë familjare, negligjencë familjare, divorci i prindërve, sëmundje në familje, trauma pas konlikteve). Shërbimi profesional është i trajnuar t'u ndihmojë nxënësve dhe/ose prindërve në këto situate ose t'i dërgojë në institucione relevante. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me institucionet relevante, siç janë: ambullanta, qendra për punë sociale, policia, etj.

Qëllimet dhe detyrat e shkollës për shëndetin e nxënësve janë përfshirë në lëndët mësimore një pjesë e orëve realizohen në orët e kujdestarisë.
Në mjedis të shëndosh kemi edhe jetë të shëndosh,1.Përparim i shëndetit në kuptim fizik (higjienën personale,mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse,edukimi seksual,droga ,alkooli,pirja e duhanit.Përparimi mental,zhvillimi i vetëbesimit,respektit,tolerancës,komunikimi etj**.**
Në realizimin e këtyre përmbajteve morën pjesë të gjithë arsimtarët përmes bisedave me prindër,me bashkëpunëtorët profesional me ligjërime të ndryshme.
Organizimi i kontrollimeve sistematike për nxënësit dhe arsimtarët si dhe vakcinime të ndryshme kundër sëmundjeve ngjitëse.

Qëllimet dhe detyrat e shkollës për shëndetin e nxënësve janë përfshirë në lëndët mësimore një pjesë e orëve realizohen në orët e kujdestarisë.

Në mjedis të shëndosh kemi edhe jetë të shëndosh,1.Përparim i shëndetit në kuptim fizik (higjienën personale,mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse,edukimi seksual,droga ,alkooli, pirja e duhanit.Përparimi mental,zhvillimi i vetëbesimit,respektit,tolerancës,komunikimi etj.

Në realizimin e këtyre përmbajteve marrin pjesë të gjithë arsimtarët përmes bisedave me prindër,me bashkëpunëtorët profesional me ligjërime të ndryshme.

Organizimi i kontrollimeve sistematike për nxënësit dhe arsimtarët si dhe vakcinime të ndryshme kundër sëmundjeve ngjitëse.
Kështuqë bashkëpunimi i shkollës tonë nuk mungon me qendrën shëndetësore si dhe bashkëpunimi i arsimtarëve me mjekun për zhvillimin psikik,fizik dhe shëndetësor të nxënësit.

**Arsimi dhe edukimi fillor i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore**

Në arsimin dhe edukimin e nx.me nevoja të veçanta arsimore niset nga parimet demokratike ,humanitare për edukim,arsim dhe aftësim për jetë.
- Planifikimi i kësaj veprimtarie në shkollë organizohet vetëm në rastet kur shkolla ka nxënës me pengesa në zhvillim, pengesa në të folur,puna logopedike,puna me fëmijë që kanë pengesa trupore, me pengesa të lehta intelektuale dhe fëmijët që kanë pengesa emocionale etj.Kurse fëmijët me dëmtime më të rënda kyçen në shkollat e veçanta me trajtim të defektologut.

Mirëpo në shkollën tone nuk kemi kushte hapsinore dhe mjete adekuate si dhe arsimtar professional për këto fëmi me pengesa të lehta psiko-fizike prandaj shkolla është e obliguar të punojë me këta fëmijë sipas kushteve që i disponon.

**Ndihma këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve**

**Ndjekja e përparimit**

**Mbajtja e evidencës për përparimin individual të nxënësve**

Mësimdhënësit mbajnë evidencë të rregullt dhe të plotë për arritjet, rregullshmërinë dhe sjelljen e secilit nxënës/nxënëse, si dhe për zhvillimin e tij/saj intelektual, social dhe emocional. Në evidencë veçanërisht janë të theksuara anët e mira të nxënësit/nxënëses dhe potencialet e tij/saj zhvilluese. Në evidencë përfshihen edhe të dhënat për përparimin e nxënësit/ nxënëses, që janë fituar si rezultat i vlerësimit të bërë nga ana e mësimdhënësve në bashkëpunim me shërbimin professional dhe prindërit e nxënësit/nxënëses.

**- Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve**

Mësimdhënësit përgatisin raporte dhe analiza të rregullta tremujore për paralelen e tyre, duke u mbështetur në evidencat individuale për nxënësit. Këto raporte dhe analiza të përgatitura për paralele të veçanta dorëzohen për mbikqyrje në shërbimin profesional dhe kuadrit udhëheqës dhe mund t'i shikojnë të gjithë mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit.

**Klima pozitive shkollore**

**Atmosfera dhe relacionet në shkollë**

**• Prestigji/imazhi i shkollës**
Shkolla njihet sipas cilësisë së lartë të punës dhe sipas arritjeve të nxënësve në lëmi të ndryshme, si dhe sipas realizimit të vizionit dhe misionit të shkollës. Shkolla kujdeset për shëndetin dhe për sigurinë e nxënësve, kultivon sensibilitetin gjinor dhe multikulturën, e mbështet ekskluzivitetin dhe përforcon participimin e nxënësve, prindërve dhe bashkësisë në jetën shkollore. Kuadri mësimdhënës gëzon respect tek prindërit.

**• Kodi i sjelljes**
Shkolla posedon Kod të sjelljes me të cilin janë përcaktuar parimet dhe dispozitat e sjelljes të të gjitha strukturave në shkollë (kuadri udhëheqës, mësimdhënësit, shërbimi profesional, personeli teknik, nxënësit dhe prindërit). Në hartimin e tij kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha strukturave, ndërsa gjatë miratimit të tij është zbatuar procedurë demokratike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha strukturave. Shkolla posedon dispozita të shkruara për reagimin në qoftë se shkilen parimet dhe dispozitat e sjelljes, të parapara me kodin dhe procedurat e tilla i zbaton në praktikë.

**• Atmosfera shkollore**
Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional midis të punësuarve. Kuadri udhëheqës dhe arsimor luajnë rol të rëndësishëm për mbajtjen e atmosferës së përhershme të mirë në shkollë, që shihet nga sjellja e tyre me nxënësit, me të punësuarit e tjerë, prindërit dhe vizitorët e shkollës. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit të kujdesen për shkollën dhe për njëri tjetrin. Pothuajse të gjithë nxënësit (pa dallim nga aftësia, gjinia,

përkatësia etnike, fetare dhe nga prejardhja) ndjehen të mirëpritur nga të rriturit dhe nga nxënësit e tjerë në shkollë.

**• Sjellja dhe disciplina në shkollë**

Disiplina e nxënësve është shumë e mirë. Ekziston atmosferë pune gjatë mësimit dhe gjatë aktiviteteve të lira, ndërsa të punësuarit përherë kujdesen për sjelljen dhe sigurinë e nxënësve gjatë kohës së pushimeve, gjatë pritjes së nxënësve dhe largimit të tyre nga shkolla. Nxënësit janë të vetëdijshëm dhe bashkëpunojnë me kuadrin dhe mes veti dhe sillen me edukatë.

Të punësuarit, me kujdes dhe me autoritet ballafaqohen me problemet, të cilat kanë të bëjnë me disiplinën dhe rregullshmërinë, dhe nuk ka ndërprerje të mësimit. Shkolla e zbaton rregulloren e masave pedagogjike në mënyrë adekuate.

**• Pjesëmarrja e nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve**

Nxënësit informohen me kohë dhe tërësisht për të gjitha punët që janë në interesin e tyre të drejtpërdrejtë dhe marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve lidhur me ato punë.

PARLAMENTI I NXËNËSVE

Në bazë të nenit 68 , paragrafi 7 sipas ligjit të arsimit fillor prej vitit 2019 ku thuhet se

(1) Të gjithë nxënësit në shkollë e përbëjnë bashkësinë e shkollës. Nxënësit kanë të drejtë t ë organizimit të nxënësve në nivel të paraleles dhe shkollës.

(2) Mënyra e organizimit të nxënësve nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullohet me statutin e shkollës.

(3) Për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore, nxënësit organizohen në bashkësitë paraleles dhe parlament të nxënësve.

(4) Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve.

(5) Konvokimin e pare të parlamentit të nxënësve e bën drejtori i shkollës.

(6) Parlamenti i nxënësve:
- merr pjesë në mënyrë aktive në përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve,
- e promovon aktivizmin e nxënësve,
- merr pjesë në aktivitetet për sigurimin e mbështetjes së moshatarëve të nxënësve me nevojat e veçanta arsimore, në realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore,
- merr pjesë në përpilimin e programit vjetor për punë,
- jep propozim-aktivitete për programet për ekskursionet vjetore,
- jep propozime për aktivitetet jashtëmësimore të shkollës,
- jep propozime për përmirësimin e standardit të nxënësve,
- merr pjesë në evalvimin e punës së shkollës,
- nëpërmjet përfaqësuesve të vet merr pjesë në këshillin e prindërve dhe këshillin e mësimdhënësve dhe
- organizon dhe marrin pjesë në aktivitete humanitare, aktivitetet ekologjike dhe punën e dobishme shoqërore.

(7) Kryetari i parlamentit të nxënësve zgjidhet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të kryetarëve të bashkësive të paraleleve në përmjet votimit të fshehtë.

**Promovimi i arritjeve**

- **Promovimi i arritjeve individuale të nxënësve**
- **Promovimi i arritjeve në emër të shkollës**

**Barazia dhe drejtësia**
- Njohja e të drejtave të fëmijëve
- Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve
- Pranimi dhe inkurajimi i multikulturalizmit

**Raporti i partneritetit me prindërit dhe më komunitetin lokal dhe afarist**

- **Bashkëpunimi i shkollës me prindërit**

*Përfshirja e prindërve në jetën shkollore*

Shkolla ndërmerr aktivitete të shumta të planifikuara mirë dhe organizon trajnime që t'i nxisë prindërit të inkuadrohen në punën edukativo-arsimore të shkollës në të gjitha nivelet. Prindërit nxiten që të marrin pjesë aktive në procesin mësimor përmes organizimit të ligjëratave në një temë konkrete ose me vizita në vendin e punës të prindit, si dhe në aktivitete të lira.
Shkolla shfrytëzon metoda efektive për komunikim me prindërit, përmes organizimit të takimeve individuale prindore dhe ditëve të hapura për pritje, duke iu përshtatur kohës së lirë të prindërve.

**• Bashkëpunimi me bashkësinë lokale**

Shkolla është inkuadruar në mënyrë aktive në jetën e bashkësisë lokale përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje me interes për bashkësinë. Shkolla promovon inkuadrimin vullnetar të nxënësve në aktivitetet e bashkësisë.

**• Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar**

**Aktivitetet shoqëror,kulturor edukativ – organizatat e nxënësve**

Shkolla realizon punë cilësore me bashkësinë afariste, përmes mësimit praktik të organizuar mirë dhe përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta të inicuara nga të dyja palët. Ekzistojnë shumë shembuj konkret për bashkëpunim të suksesshëm me sektorin joqeveritar dhe pjesëmarrja aktive e të punësuarve në projekte me interes të bashkësisë.

Funksioni i organizatave të nxënësve në përparimin e jetës së tyre përfshihet edhe në procesin edukativo-arsimor.Shkolla jonë edhe këtë vit do ti vazhdojë aktivitetet kulturore edukative në nivel të lidhshmërisë së afërt me mjedisin lokal-vendor.
Këtu do të përfshihen këto aktivitete:
Funksioni i organizatave dhe shoqatave të nx.në edukimin dhe ngritjen e kulturës demokratike.
Në kuadrin e aktivitetit shoqëror të nx.organizohen komisione dhe aktive të tyre me udhëheqës të tyre:

Komisioni për aktivitetin shoqërort të nxënësve
Komisioni për aktivitetin kulturor
Organizata e fëmijëve
Bashkësia e nxënësve të shkollës
Lidhja e ekologëve të rinj
Kryqi i kuq etj.
Bashkëpunimi i shkollës me ente dhe institucione për realizimin e qëllimeve dhe detyrave.
Bashkëpunimi i shkollës përkatësisht i arsimtarëve me prindërit e nxënësve dhe njerëz të kulturës e shkencës.
Informimi i medijave për rezultatet e arritura të shkollës etj.

## Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës

### Puna e organeve profesionale në shkollë

Këshilli shkollor është konstituuar në pajtim me rregulloren ligjore dhe Statutin e shkollës. Kompetencat për menaxhim janë qartë të definuara me Rregulloren e punës së Këshillit shkollor. Mbledhjet mbahen me shumicën e anëtarëve të këshillit. Këshilli shkollor u siguron informata të hollësishme dhe të gjithanshme për punën e vet, të gjitha subjekteve të kyçura në procesin edukativo-arsimor.

## Menaxhimi i shkollës

Organi udhëheqës ka përcaktim strategjik, të mbështetur në vizionin e qartë që i përmban pikëpamjet dhe nevojat e të gjitha palëve të përfshira në jetën shkollore. Organi udhëheqës ka njohuri se në çfarë mënyre objektivisht t'i vlerësojë cilësitë e të punësuarve dhe kontributin e tyre në punën ekipore dhe si ta promovojë praktikën e mirë që ekziston në shkollë. Sjell vendime përgjegjëse. Ka ndërtuar kredibilitet personal dhe marrëdhënie profesionale ndaj punës që mbështetet në shkathtësitë dhe dituritë më të reja, duke përfshirë dhe aftësinë efektive që të delegojë, të komunikojë dhe të udhëheqë me të punësuarit dhe zhvillimin e tyre.

Në këtë strukturë përfshihen këto elemente:

- Puna e Këshillit të arsimtarëve
- Puna e Këshillave të klasave
- Puna e kujdestarëve të klasave

## Qëllime dhe krijim i politikës shkollore

Qëllimet e shkollës janë në përputhje me qëllimet e politikës arsimore lokale dhe shtetërore. Qëllimet janë të qarta dheprecize dhe janë të fokusuara në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjes maksimale të të gjithë nxënësve. Tëpunësuarit, prindërit dhe nxënësit marrin pjesë aktive në krijmin e qëllimeve, parimeve dhe vlerave të shkollës dhe janë të njohtuar me mënyrën e realizimit dhe përmirësimit të tyre.

Të punësuarit marrin pjesë aktive në krijimin dhe azhurnimin e strategjive për realizimin e qëllimeve. Shkolla i merr parasysh edhe mendimet e prindërve dhe nxënësve.

## Planifikimi zhvillimor

### - Qëllimet e planifikimit zhvillimor

Qëllimet janë precize, të qarta dhe e reflektojnë misionin, vizionin dhe vlerat e shkollës. Gjatë përcaktimit të qëlllimeve inkuadrohen mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale. Shkolla ka plane aksionare për qëllimet e përcaktuara të cilat i zbaton në mënyrë konsekuente dhe ka plan për ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të aktiviteteve dhe arritjet e caktuara për sukses.

- **Zhvillimi profesional/trajnimi profesional i kuadrit**

Shkolla vazhdimisht i identifikon nevojat për trajnim profesional të kuadrit. Ka përgatitur program dhe ka siguruar mjete financiare në pajtim me nevojat e trajnimit profesional të të gjithë të punësuarve dhe avancimit të procesit edukativo-arsimor, duke përfshirë trajnimin për punë me nxënës që kanë nevoja të veçanta arsimore.

- **Mjetet materiale dhe teknike**

Shkolla i identifikon me kohë nevojat për mjete materiale dhe teknike dhe vazhdimisht i planifikon dhe i siguron ato. Mjetet ekzistuese të konkretizimit janë në funkcion dhe shfrytëzohen në mënyrë optimale. Shkolla planifikon dhe siguron mjete për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

- **Infrastruktura**

Shkolla vazhdimisht shqyrton planin për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete tëveta dhe mjete të donatorëve për investime të dedikuara. Shkolla ka bashkëpunim me vetqeverisjen lokale dhe bashkësinë lokale për të përmirësuar infrastrukturën.

**Puna e drejtuesve të shkollës**

- Puna e drejtorit të shkollës
- Puna zëvendësdrejtorit ose ndihmës drejtorit

**Puna e shërbimeve profesionale**

- Puna e pedagogut,psikologut
- Puna e bibliotekistit

**Puna e organeve udhëheqëse të shkollës**

- Puna e Këshillit të shkollës
- Puna e organeve profesionale
- Puna e këshillit të prindërve

## KUADRI MËSIMOR

- Arsimtari klasor e udhëheq klasën e tij prej klasës së I ,mandej vazhdon tjetri gjegjësisht II ,III,IV deri në V.
- Vendosja graduale e arsimtarëve lëndor ( lehtësohet kalimi prej mësimit klasor në mësim lëndor)
- Prej klasës së I angazhohet arsimtar lëndor për gjuhën angleze
- Në klasën e V për arsimin e lëndëve natyrore angazhohen arsimtar lëndor,si dhe për artet dhe arsimin teknik ,nëqoftëse ka arsimtar lëndor në shkollë,
- Prej klasës së VI deri te IX angazhohen arsimtarë lëndor për secilën lëndë mësimore.
- Është theksuar nevoja pë trajnimin e arsimtarëve për zbatimin e programeve të reja mësimore për të gjitha lëndët.
- Është përpunuar propozim për përmirësimin e arsimit inicial të arsimtarëve ,në pëputhje me konceptin e ri si dhe për përkryerjen dhe përparimin e tyre në karrierë.
- Bashkëpunim i përforcuar me prindërit dhe pjesëmarrja e tyre në jetën dhe punën në shkollë.

## MËSIMDHËNËSI

Mësimdhënësi është hallka bazë e mësimdhënies. Ai/Ajo ka për mision dhe detyrë të përcjellë te nxënësi dije sa më të gjërë, të saktë dhe korrekte në pikëpamje shkencore, kulturore e edukative.
Mësimdhënësi- edukatori është reflektues i disiplinës së ndërgjegjshme dhe shembull i mirë për nxënësit ose fëmijët e institucionet edukativo-arsimore. Ai është përgjegjës, gjithashtu, edhe për edukimin dhe formimin korrekt të nxënësve me normat dhe sjelljet e shëndosha morale.
Veshja e personelit edukativo-arsimor nuk duhet të jetë provokative, por në përputhje me normat pedagogjiko-arsimore të sistemit arsimor të Republikës së Maqedonise.

Të punësuarit gjatë procesit mësimor, duhet të mbajë uniformën e shkollës, të realizojë planprogramin e procesit edukativo-arsimor, të respektojë disiplinën e orarit të mësimit, duke kërkuar me korrektësi edhe prej nxënësve.

Përveç procesit të rregullt mësimor, mësimdhënësi duhet të organizojë edhe takime në grupe ose me klasa të caktuara, për tematika dhe objektiva specifike që do t'u shërbenin nevojave për mësim plotësues të nxënësve.
Mësimdhënësi çdo ditë duhet të jetë i përgatitur me ditarin përkatës të punës, i cili duhet të jetë analitik, racional dhe të pasqyrojë teknologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, punën në grupe, punën individuale, të mësuarit aktiv e krijues etj.
Ai duhet t'i ndihmojë dhe udhërrëfejë nxënësit për përdorimin e kompjuterëve, projektorit, veglave muzikore dhe pajisjeve të tjera, të përgatisë orët e mësimit me demonstrime e me mjete konkrete: CD, DVD, tabela, vizatime etj.
Mësimdhënësi mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e orendive, pajisjeve të klasës . Në rast të shkatërrimit ose dëmtimit, duhet menjëherë të raportojë në drejtori.

Mësimdhënësi mban përgjegjësi për pjesëmarrjen e nxënësve në mësim si dhe lejon largimin e tyre nga mësimi, në rastet që i konsideron të arsyeshme.

## Mësimdhënësi kujdestar i klasës

Mësimdhënësi pergaditë planin e bashkësisë së klasës. Detyrë e kujdestarit të klasës dhe të punësuarit tjerë edukativo-arsimor që në fillim të vitit shkollor të fillojë të mbajë orët e bashkesise se klases sipas planit, t'i informojë nxënësit dhe prindërit me dispozitat e kësaj rregulloreje, me rendin shtëpiak në shkollë, me Kodin e Mirësjelljes, me obligimet e tjera që kanë nxënësit, si dhe me pasojat që mund të kenë nëse nuk i respektojnë ato.

Për një punë efektive dhe të gjithanshme me nxënësit, mësimdhënësi duhet të punojë në mënyrë aktive me të gjithë prindërit e nxënësve, në takimet e caktuara periodike (mujore). Mësimdhënësi kujdestar me fletëthirrje thërret prindërit në takime, që duhet të organizohen dhe planifikohen mirë, duke këmbyer mendime dhe përvoja për nxënësit. Mësimdhënësi kujdestar me prindërit mban edhe komunikim përmes nxënësit, me telefon, me E-mail, me shkrim etj.

Mbi bazën e takimeve me prindër si dhe punës së rregullt me nxënës, mësimdhënësi (kujdestar), në periudhën tre mujore, harton një karakteristikë për secilin nxënës, formatin e të cilit e nxjerr Drejtoria e

Arsimit. Karakteristika duhet të përmbajë: evoluimin e nxënësit në mësime, qëndrimet e tij, sjelljet, sukseset, problemet, edukimin etj.
Kujdestari i klasës e ka për obligim t'i kryejë të gjitha punët administrative në ditarin e klasës-elektronik dhe në librin e amzës që ai udhëheq.
Për këtë punë edhe mban përgjegjësinë e plotë të plotësimit të të dhënave personale të nxënësit.
Kujdestari i klasës ka për obligim t'i këshillojë nxënësit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit dhe pasurisë shkollore, si dhe kryerjen e obligimeve të tjera të nxënësit që dalin nga rregulloret e shkollës,- dhe MASHT-it.
Kujdestari i klasës ka për obligim t'i identifikojë dhe evidentojë nxënësit që e shkatërrojnë ose dëmtojnë inventarin e shkollës dhe ata t'i paraqes në drejtorinë e shkollës.

**Kodeksi për sjelljet në shkollë**

1. Për qëndrim të këndshëm, të sigurtë dhe të suksesshëm në shkollë të nxënësve , të punësuarve dhe vizitorëve duhet të respektohen rregullat e poshtëshënuara të sjelljeve.

2. Në shkollë, nxënësit tjerë dhe personat e rritur që nuk janë në punë në shkollë, nuk munden të hyjnë me vetë dëshirë dhe në çdo kohë. Detyrat e tyre janë që të paraqiten te personeli teknik në hyrjen kryesore , i cili do tu ndihmojë që më lehtë dhe më shpejtë t'ia arrijnë qëllimit të vizitës pa çrregullime në procesin mësimor.

3. Mund të hyjnë nëpër klasa në orë mësimore nëse e njëjta nuk është informuar arsimtari.Të njëjtët nuk guxojnë që për nevoja personale t'i mbajnë arsimtarët nëpër korridore jasht klasëve me çka parandalojnë zhvillimin normal të mësimit.

4. Për zbatimin e rregullave të lartpërmendura janë përgjegjës nxënësit, udhëheqësit e klasëve, arsimtarët kujdestar,personeli teknik, shërbimi pedagogjiko-psikologjik, ndihmës drejtori dhe drejtori i shkollë .

**Puna në dokumentacionin pedagogjik shkollor**

- Puna, ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit
- Dosja e nxënësve
- Dokumentacioni tjetër shkollor (libri amë I nx.,dëftesat,librezat e nx.dhe fletëtransferi)

Arsimi dhe edukimi fillor i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Në arsimin dhe edukimin e nx.me nevoja të veçanta arsimore niset nga inkluzioni i tyre dhe parimet demokratike për edukim, arsim dhe aftësim për jetë.

Planifikimi i kësaj veprimtarie në shkollë organizohet vetëm në rastet kur shkolla bën identifikimin e nxënësve me pengesa në zhvillim, pengesa në të folur,punë me logoped, defektolog puna me fëmijë me nevoje te veçanta me pengesa të lehta intelektuale e fëmijët që kanë pengesa emocionale , vështirësi në mësime etj.Kurse fëmijët me dëmtime më të rënda ,me nevoja të veçanta kyçen në shkollat te specijalizuara dhe rehabilitimi i tyre në këto institucione.

Mirëpo në shkollën tone nuk kemi kushte hapsinore dhe mjete adekuate si dhe arsimtar professional për këto fëmi me pengesa të lehta psiko-fizike prandaj shkolla është e obliguar të punojë me këta fëmijë sipas kushteve që i disponon.

Nga harmonizimi dhe lidhshmëria reciproke e kësaj structure komplekse në procesin edukativo –arsimor mvaret klima pedagogjike që krijohet në shkollë.

Qëllimet e shkollës janë të qarta të, reflektojnë misionin, vizionin dhe vlerat e shkollës në procesin edukativo –arsimor, përmes bashkëpunimit të shërbimit pedagogjiko-psikologjik , me angazhimin dhe përkrahejn e kolektivit (arsimtarëve), nxënësve tanë iu mundësua motivimin e tyre, përgjegjësi individuale ,besueshmëri, edukim dhe përvetësim të diturive të reja përshkak se këto janë elemente përbërëse në sistemin e arsimimit cilësor në shkollë.

***Plan për mbrojtje nga zjarret, tërmetet dhe fatkeqësitë elementare natyrore***

| **Aktiviteti** | **Qëllimet** | **Realizimi** | **Resurset** | **Efektet** | **Koha** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Testimi i sinjaleve për rezik** | Caktimi i sinjalit të vërtetë | Ekipi për planifikim | Plani | Nxënësit e njohin shenjën | Shtator |
| **Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë –mësimi lëndor** | Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë | Ekipi për evakuim të shpejtë | Plani skematik | Ekipi është aftësuar për aksion | **Tetor** |
| **Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë –mësimi klasor** | Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë | Ekipi për evakuim të shpejtë | Plani skematik | Ekipi është aftësuar për aksion | **Nëntor** |
| **Evaulimi i aktiviteteve të realizuara** | shqyrtimi i lëshimeve | Ekipi i arsimtarëve | Plani dhe procesverbali | Lëshimet janë vërejtur | Shkurt |
| **Aktivitet ushtrues për ndihmën e parë mjekësore** | Aftësimi i ekipit për ndihmë të shpejtë | Ekipi për ndihmë të | Materiali medicinal | Intervenim praktik dhe i suksesshëm | **Prill** |
| **Evaulimi i aktiviteteve të realizuara** | **Shqyrtimi i veprimeve pozitive dhe negative** | **Ekipi i arsimtarëve** | **Procesverbalet** | **Janë shqyrtuar masat e** | **Maj** |

*Qëllimet mësimore dhe aktivitetet e tjera gjatë vitit shkollor 2022/2023 do të jenë:*

1. Kyçja në projekte të reja

2. Vazhdim të realizimit të projektit për modernizimin e shkollës me qëllim implementimin e plotë të projektit në shkollë

3. Përcjellje dhe përparimin e mësimdhënies, vlerësimi formativ,sumativ dhe
përshkrues,

4. Mësimi plotësues,shtues, zgjedhor dhe aktivitete të lira të nxënësve

5. Përcjellja dhe përmirësimin e punës së aktiveve profesionale

6. Intensifikimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve përmes seminareve, konsulltimeve, këshillimeve,punëtorive etj ku përvojat dhe njohurit e këtyre formave të zhvillimit do të përcillen te të punësuarit e tjetë në shkollë.
7 .Organizimin e garave shkollore te shumica e lëndëve mësimore me qëllim zbulimin dhe përcjelljen e nxënësve të talentuar si dhe praninë e pjesëmarrjen e prindërve në të gjitha aktivitetet e shkollës.

***Qëllimet e shkollës***

 Rritja e suksesit të nxënësve

 Ulja e numrit të mungesave

 Zhvillimin e motivimit më të madh te nxënësit që të angazhohen në aktivitete të ndryshme të nxënësve në secilën lëndë,

 Zhvillim të nxënësve të talentuar në atë fushë që ato më shumë i tërheq ,

 Vendosja e procesit edukativo-arsimor në parimet e mësimdhënies moderne,

 Thellimi dhe zgjerimi i njohurive të nxënësve në funksion të zbatimit praktikë të tyre,

- Nxënësit të marrin njohuri, të zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre të nevojshme

- për arsimim të mëtutjeshëm.

- Sigurimi i arritjeve dhe suksesit të lartë.

- Rritja e motivimit te nxënësit dhe mësimdhënësit,

- Rritja e bashkëpunimit dhe mbështetja me mjedisin lokal,

- Ndërtimi i sistemit të vlerësimit , me mënyrat e qarta , precize dhe mjeteve të vlerësimit.

## Vetevleresimi apo vetëevaluimi i shkolles

Në bazë të Ligjit për arsimin fillor të nenit 129 në secilën çdo dy vjet realizohet vetëevaluimi i të arriturave dhe suksesit të punës edukativo arsimore në shkollë.
Vetëevaluimin e e përcjell dhe e realizon komisioni I përbërë prej pesë anëtarëve nga rradhët e arsimtarëve ,shërbimi profesional e prindërve ku me propozimin e drejtorit e formon Këshilli i shkollës.
Qëllimet e vetëvlerësimit për v.sh.2021/2022 janë: zbatimi dhe përparimi i anëve pozitive dhe njëkohësisht eliminimi i anëve negative që janë vërejtur nga periudha e kaluar.Si anë të forta të vetëvlerësimit janë:
Komisioni përgaditë raportin e vetëevaluimit për përmiresimin e kualitetit të mësimit dhe kushteve të tjera shkollore.

***Pikat e forta te shkolles***

 Raportet ndernjerezore te shendosha;

 Struktura kualifikuese e mesimdhenesve;

 Kreativiteti i mesimdhenesve;

 Opinioni pozitiv per shkollen;

 Predispozitat intelektuale te nxenesve;

 Gadishmeria e komunitetit te prindeve per bashkpunim me shkollen;

 Funksionalizimi i organeve profesionale te shkolles;

 Bashkpunimi me mjedisin shoqeror;

 Aktivitetet jashtemesimore te nxenesve te shkolles;

 Siguria e duhur ne shkolle;

 Vijushmeria e mire e nxenesve ne mesim;

***Pikat e dobeta te shkolles***

 Hapsira e pamjaftushme shkollore ( per mesim dhe aktivitete jashtemesimore);

Mjete finansiare per rregullimin e oborrit të shkollës

 Mungesa e mjeteve dhe teknologjive bashkohore mesimore;

 Mungesa e kabineteve te shkencave te natyres: kimi, fizike, biologji, matema

 Mungesa e sallës sportive

 Gaditshmeria e mesimdhenesve per trajnime dhe pergatitje profesionale me nxënës me vështirësi në mësime

 Buxheti i kufizuar i shkolles;

 Buxheti i kufizuar komunal per investime kapitale;

**Përkrahja e nxënësve**

## *Arritjet e nxenesve*

Përcjellja dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve në shkollë është kryer vazhdimisht gjatë gjithë vitit shkollor me një analizë të situatës në katër periudhat klasifikuese.
Të Arriturat e nxënësve në shkollë vlerësohen me vlerësim përshkrues dhe numerikisht.
Në periudhën e parë të procesit edukativo mësimor (I-III kl.) vlerësimi apo notimi është në mënyre përshkruese, në periudhën e dytë (IV-VI kl.) të arriturat e nxënësve në lëndët obligative dhe zgjedhore vlerësimi është përshkruese dhe numerikisht ,kurse në fund të gjysëmvjetorit të parë dhe në fund të vitit shkollor vlersimi është numerikisht,kurse gjatë tremujorve është përshkrues. Nxënësit në periudhën e tretë (klasën VII-IX) nxënësit vlerësohen numerikisht me notat nga (1) deri (5).

Vlerësimet kryhen individualisht dhe në grupe, kryehen me instrumentet dhe teknikat e testimit (me gojë dhe me shkrim, teste, ushtrime me shkrim, detyrat e kontrollit, ese, projekte etj.).
Vlerësimi i nxënësve kryhet edhe në përputhje me kriteret dhe standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit.
Kujdestari i klasës është i obliguar gjatë vitit shkollor d o t ë përcillen arritjet e nxënësve, rregullsia dhe sjellja e tyre. D o t ë Bëhen analiza për suksesin për lëndët e caktuara në të cilët nxënësit arrijnë rezultate më të dobëta, ku d o t ë organizohet mësimi plotësues. D o t ë Identifikohen nxënësit me vështirësi gjatë mësimit dhe me të njëjtit, shërbimi profesional d o t ë realizon biseda këshillëdhënëse, Do të i udhëzon në teknikat efikase të mësimit dhe ndërtimit të shprehive të punës. Gjithashtu identifikohen edhe nxënësit e talentuar të cilët përmes mësimit shtesë i zgjerojnë dhe thellojnë dituritë e tyre që të marrin pjesë në gara. Nxënësve u d o t ë u mundësohet që aktivitetet e tyre ti prezantojnë para opinionit të gjerë si dhe të marrin pjesë në gara. Nxënësve u mundësohet që aktivitetet e tyre ti prezantojnë para opinionit të gjerë si p.sh.: projekte kulturore dhe teatrore, pjesëmarrje në emisionet televizive, ekspozita, projekte etj.

**PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E DREJTORIT TË SHFK „KIRILI E METODIJ„ F.RRAMANLI**
**për vitin shkollor 2022/ 2023**

Ndryshimet e mëdha shoqëroro-ekonomike imponuan shumë, shqyrtime të reja, sjellje të reja dhe gjithsesi shumë dilema dhe sfida. Paraqitet nevoja për pajisje me dituri dhe shkathtësi të reja, e kjo nga ana vet imponon nevojë për shfrytëzimin e teknologjisë bashkëkohore arsimore, për edukimin e raporteve të reja kualitative mes nxënësve në proçesin edukativo- arsimor dhe qasje e re e shkollës. Për shfrytëzimin e teknologjisë bashkëkohore arsimore, për edukimin e raporteve të reja kualitative mes nxënësve në proçesin edukativo- arsimor dhe qasje e re që shkolla tu përshtatet trendeve të teknologjisë bashkëkohore.

Procesi edukativo arsimor është një nga sferat më me perspektivë në jetë, andaj duhet tu ofrojmë kushte moderne nxënësve tanë që të arsimohet sipas trendeve dhe modeleve të reja.
Jemi të obliguar që ti ndjekim dhe përcjell ndryshimet në arsim e shkencë, jam i vetëdishëm edhe për problemet civilizuese në shtetin

tone dhe rrethin ku jetojmë . Andaj si drejtor do të dëshiroja që në shkollën tonë të krijoj kushte dhe të kultivoj klimën në të cilën nxënësi do të pajiset me dituri kualitative, do të mësojë se si ti zbatojë dituritë,njohuritë dhe shkathtësitë e arritura .

Si njëri nga parakushtet për sukses është të kontriboj për krijimin e kushteve që të punësuarit në shkollë ta duan punën, të motivohen, ndjehen krenar dhe të kënaqen duka punuar, sepse një pjesë e madhe e veprimtarisë është e lidhur me aftësitë personale, shkathtësitë, kreativitetin dhe motivimin e kuadrit mësimor.

-  Në shkollë do të zbatohet didaktikë moderrne, njëjtë e fokusuar në mësimin e grupit të lëndëve matematiko - natyrore, lëndët shoqërore, gjuhët mirëpo edhe të lëndëve që janë në funksion të arsimit të mesëm profesional.

-  Shkolla maksimalisht do ti shfrytëzojë dobitë që i ofrojnë paisjet kompjuterike,interrneti, dhe do të insistojë që e njëjta të sendërtohet dhe të modernizohet.

-  Punëtoritë e nxënësve me kapacitetet e përgjithshme do të vehen në funksion të aftësimit profesional të nxënësve, mirëpo edhe maksimalisht do të shfrytëzohen si burim i mundshëm i finansave në shkollë.

-  Në shkollë do të regjistrohen dhe do të mësojmë filloristët më të mirë dhe më të suksesshëm, të cilët do të paisen me dituri dhe shkathtësi .

-  Shkolla do të funksionojë në bazë të korrnizave kohore të përshtatshme për nevojat e shkollës dhe për atë çka presin prindërit.

-  Shkolla do të ketë ofertë të madhe të aktiviteteve plotësuese në funksion të përmirësimit të kualitetit dhe nivelit të diturive të nxënësve, mirëpo edhe të përmirësohet raporti dhe bashkëpunimi në relacion nxënës-nxënës, nxënës- arsimtar, arsimtar-arsimtar.

-  Nxënësit do të kenë mundësi të zgjedhin aktivitetet sipas intereseve të veta nga sfera e sportit, muzikës,artit sipas mundësive të tyre psiko fizike.

-  Do të profesionalizohen arsimtarët për të organizuar dhe realizuar mësim me qëllim që orët të bëhen më interesante dhe më të larmishme.

 Nxënësit dhe arsimtarët tonë do të jenë të motivuar të marrin pjesë dhe të fitojnë çmime në gara, konkurse, panaire dhe manifestime tjera.

 Ekskurzionet e nxënësve do të organizohen në bazë të planit dhe programit më parë të përpiluar në funksion të komponentës edukativo-arsimore sipas rregullores së MASH.

 Do të ndejken projektet e ofruara, kurse arimtarët do të trajnohen për shkak të përcjelljes të trendeve moderrne në arsim.

 Do të merren aktivitete për krijimin e kushteve të këndshme për punë në objektin e shkollës
 Shkolla do të kultivojë relacione afërsie me prindërit e nxënësve, do të bashkëpunojë me bashkësinë lokale .

*Mënyrë e planifikuar e implementimit*

 Përpilimi i planit afarist, me çka do të merren parasysh të gjitha mënyrat e
mundëshme për kontribut në buxhetin e shkollës.

 Formon ekipë në të cilat do të ketë edhe persona të jashtëm profesional, me qëllim që të përpilojë pjan për pjesmarre aktive në punëtoritë shkollore dhe në oranyheritë, të nëjtit përkrah funksionit themelorë arsimorë do të jenë burim i finansave për shkollën.

 Përpilimi i ofertës, planit dhe programit për aktivitete jashtëmësimore.

 Përpilimi i principeve për bashkëpunim me prindër dhe organizata punuese veprimtarija e së cilës ëahtë kompatibile me profitet arsimore në shkollën tonë .

 Pëprilimi i planit për pjesëmarje në gara.

 Formimi i ekipit i cili do ti konstatojë prioritete në shkollë
Përpilimi dhe implementimi i ciklit për trajnim të arsimtarëve.

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E DREJTORIT

***Roli i drejtorit***

Organi udhëheqës i shkollës është drejtori,ky është përgjegjës pët ligjshmërinë në punë dhe për punën materiale-finansiare të shkollës. Duke e pasur parasysh vend pozitën dhe strukturën e shkollës, popullatën vendase, rrethin lokal, jam nisur nga parashikimi bazë se programin të cilin e kam përgaditur, paraqet edhe përgjegjësi të madhe për realizimin e plotë.

Ky program ka për qëllim të planifikohen dhe programohen detyrat e parashtruara të drejtorit, të përcaktohen format, metodat dhe afatet e realizimit të suksesshëm të procesit edukativo-arsimor, si dhe të ndiqen, analizohen dhe studiohen probleme të ndryshme të cilat do të paraqiten gjatë punës.

Gjatë përgatitjes së programit dhe planit operativ para së gjithash e kam pasur parasysh rëndësinë e veprimtarisë të cilën e kryen organizata, situatën në shkollë dhe rrethinën e saj si dhe miratimin e aktiviteteve të cilat janë të varura nga periudha e kaluar dhe e tashme, gjegjësisht ardhmërisë së shkollës, ndërsa në plan të parë këtu bëjnë pjesë:

a). Filozofia dhe politika e organizimit;

b). Vizioni për të cilin synoj;

c). Strategjia me të cilën do të arrihen qëllimet e parashtruara.

Qëllimi im, gjegjësisht misioni i shkollës është të siguroj arritjen e rezultateve më të mëdha në sferën e arsimit dhe gjatë këtij procesi çdoherë të merret informatë (përgjigje) rikthyese.

Gjatë përgatitjes së këtij programi parasysh e kam pasur edhe zhvillimin e marrëdhënieve reciproke me shkollat dhe institucionet tjera nëpërmjet transferimit të diturive dhe të mësuarit për qasje më aktive në drejtim të ndryshimeve në vetë organizatën:

1. Shkolla

2. Shkollat tjera

3. Organizata punuese

4. Organizata joqeveritare

5. Komunën e Kumanovës

6. MASH 7. BZHA

Posaçërisht do të përpiqem që të punojë në fushën e integrimit të shkollës me rrethin lokal, që nënkupton hapjen e shkollës për të gjithë të interesuarit.

Në veprimtarinë arsimore përparësi do t'i jap punës dhe mësimit ekipor (në bazë të vizionit tim personal i cili më udhëheq në punë për arritjen e suksesit si menaxher në arsim, që nënkupton se ai i cili ka edhe zhvillon, jep, krijon, mëson), ndërsa njëherë do të përpiqem që shkolla të jetë në hap konform formave dhe strategjive të reja të shkollës së sotme bashkëkohore.

Në këtë drejtim në shkollë janë duke u realizuar disa projekte të cilat kanë si pikësynim arritjen e rezultateve më të larta në procesin edukativo-arsimor, konkretisht përmirësimin e rregullshmërisë së nxënësve dhe motivimin e tyre si dhe përsosjen profesionale të arsimtarëve.

Gjithashtu do të përpiqem të krijoj kushte për punë në dy ndërrime, e tërë kjo në bashkëpunim me MASH dhe komunën e Kumanovës.

Puna ime pedagogjike do të jetë për përputhje më Ligjin për arsim fillor, Planin dhe programin mësimor, aktet normative të sjella për nevojat interne të shkollës, kurse puna këshilldhënëse do të jetë në drejtim të dhënies së udhëzimeve, këshillave, ideve si dhe ndërtimit të vizionit të përbashkët me të punësuarit. Në programin për punë të drejtorit përveç planit operativ do të përgatis edhe plane mujore, javore si dhe tematike, në varshmëri me llojin e veprimtarive, fushave përmbajtësore me aktivitete të konkretizuara, bartësit e tyre si dhe

dinamikën e realizimit. Evidencën dhe dokumentacionin për aktivitetet ditore do ta paraqes në ditarë të veçantë.

Gjithashtu në punën time të përditshme do ti realizoj dhe zbatoj vendimet të cilat do t'i sjellin organet drejtuese në shkollë, njëkohësisht do t'i harmonizoj angazhimet e mia personale për komunikim më të madh me nxënësit, prindërit, këshilltarin rajonal të BZHA-së, inspektorët shtetëror të arsimit të Kumanovës , si dhe të gjithë të tjerët të cilët janë të interesuar për punën e shkollës, posaçërisht bashkëpunimi me rrethin lokal me qëllim të afirmimit më të madh të shkollës.

Bashkëpunimi në këtë drejtim do të jetë edhe me kolegët e mi – drejtorët e shkollave të regjionit të Kumanovës dhe më gjerë si dhe komunikimi me këshilltarët dhe zyrtarët e BZHA-së nga regjioni dhe MASH-i.

**Drejtori i kryen punët në vazhdim:**

- e përfaqëson dhe e paraqet shkollën dhe është përgjegjës për punën ligjore;
- e organizon, planifikon dhe udhëheq punën e shkollës fillore ;
- përgatit propozim të programit vjetor për punë dhe është përgjegjës për realizimin e programit vjetor.
- është përgjegjës për realizimin e të drejtave dhe detyrat e nxënësve.
- Kryen zgjedhjen e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe kuadrit tjetër administrativo – teknikë në pajtim me ligjin dha aktet e shkollës;
- Kryen shpërndarjen e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe kuadrit tjetër administrativo – teknikë;
- Vendos për ndërprerjen e mardhënieve të punës së arsimtarëve, , bashkëpunëtorëve profesional dhe kuadrit

tjeter administrativo – teknikë në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive;

- Ngrit aftësimin profesional dhe përkryerjen e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë

**PLAN PËR PUNËN E KËSHILLIT TË SHKOLLËS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023**

| Nr. | Përmbajtja | Qëllimi | Bashkëpunëtor dhe realizues | Koha e realizimit | Efekti i pritur |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Definimi i qëllimeve prioritare të shkollës për vitin shkollor ne vijim | Përshtatja e qëndrimeve për misionin dhe vizionin e shkollës | Drejtori, shërbimi prof., bashkësia e kl., Këshilli i shk. | Gusht | Realizimi i qëllimeve të shkollës në realizimin e procesit EA. |
| 2 | Miratimi i programit vjetor për punën e shkollës dhe dorëzimi te Këshilli i komunës | Vendosja në funksion i dokumentit themelor për punën e shkollës | Drejtori, Shërbimi prof. Këshilli i arsimtarëve | Gusht | Realizim i suksesshëm i qëllimeve të parapara |
| 3 | Dhënia e mendimit për pranimin e kuadrit arsimor deri te drejtori i shkollës | Përfaqësimi me kuadër kualitativ dhe profesional | Drejtori Këshilli i shkollës | Gusht | Punësimi i kuadrit në funksion të mësimit |
| 4 | Sjellja e planit financiar për punën e shkollës | Shpërndarja e buxhetit për nevojat e shkollës për vitin rrjedhës | Arkëtari Kontabilisti Drejtori Këshilli i shkolles | Nëntor | Shfrytëzimi i mjeteve qëllimore |
| 5 | Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor dhe gjysmëvjetorit për punën e shkollës | Vështrime për realizimin e qëllimeve prioritare dhe aktiviteteve tjera të parapara me Programin vjetor të shk. | Drejtori Kësh. I prindërve Kësh. i arsimtar. Kësh. i klasave | Shkurt Qershor | Ndjekje e vazhdueshme e suksesit të nxën. dhe punës në tërësinë shkollë |
| 6 | Shqyrtimi dhe miratimi i llogarisë përfundimtare të shkollës | Tejkalimi i parregullsive në punën financiare në kuadër të | Arkëtari Kontabilisti Drejtori Këshilli i shkoll. | Shkurt | Shfrytëzimi i mjeteve qëllimore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | rregullores ligjore | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Mbledhje sipas ankesave dhe kërkesave të prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve | Respektimi i rregolleres ligjore dhe kritereve të ndryshme për qëllime të ndryshme | Drejtori<br>Shërbimi prof.<br>K.i prindërve<br>K. i arsimtarëve<br>K. i shkollës | Gjatë tërë vitit | Vlerësimi i punës dhe efikasitetit të shkollës gjatë realizimit të PEA |
| 8 | Evaluimi punës së Këshillit të shkollë dhe formimi i grupeve punuese për përgatitjen e programit të ri për punë | Strategji konstante për punë të suksesshme të KSH dhe tejkalimi i mangësive | SHF<br>Drejtori<br>Kësh. i prindërve | Qershor | Menaxhim i suksesshëm dhe kualitativ i institucionit edukativ-arsimor |

## Detyrat e Këshillit të shkollës

Këshilli i shkollës i kryen punët në vijim:

- Miraton statutin për shkollën fillore;
- Propozon program vjetor për punë dhe raport për punën e shkollës fillore komunale deri te këshilli i komunës;
- Sjell program për zhvillimin e shkollës;
- Sjell program për kyçjen e standardeve më të larta dhe programe tjera;
- Propozon plan financiar deri te themeluesi;
- Propozon llogari përfundimtare deri te themeluesi;
- Shpall konkurs për zgjedhje të drejtorit të shkollës fillore komunale;
- Mban intervistë me kandidatët për drejtor;
- Kryetarit të komunës i propozon një, përkatësisht dy kandidat nga kandidatët e paraqitur në konkursin për drejtor të shkollës;
- Jep mendim deri te drejtori për zgjedhjen e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve;
- Parashtron propozim deri te drejtori për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për të punësuarit në shkollë;
- Vendos për ankesat e të punësuarve në shkollën fillore;
- vendos për ankesat e nxënësve, prindërit, përkatësisht kujdestari i nxënësit
- zgjedh komisionet e veta të përhershme dhe të përkohshme, i emëron dhe i shkarkon anëtarët e tyre, e cakton rrethin e tyre të punës.

(1) Kompetencat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni këshilli i shkollës i realizon në pajtim me Rregulloren për punën e Këshillit të shkollës.

## PROGRAMI PËR PUNËN E PEDAGOGUT PËR VITIN SHKOLLOR 2022/ 2023





Gjatë vitit shkollor kishim parasysh dhe punohej sipas Ligjit të arsimit fillor, programeve përmbajtësore dhe akitiviteteve të dhëna nga programi vjetor për punën e shkollës edukativo-arsimore.

Në fillim të vitit shkollor në mënyrë active morëm pjesë – në problemet dhe detyrat pedagogjike të cilat janë të inkorporuara në programin vjetor të shkollës për këtë vit shkollor. Pjesemarrja ne percjelljen dhe ndihma profesionale gjate organizimit te procesit mesimor.

Pjesemarrja ne percjelljen dhe ndihma ne organizimin dhe realizimin e aktiviteteve te lira te nxenesve , bashkesia e nxenesve,pune te dobishme dhe ekskurzionet e nxënësve.

Programi vjetor do te realizohet ne bashkepunim me drejtorin , arsimtaret , nxenesit prinderit , me puntore profesional te MASH-it , te BZHA-se dhe institucioneve tjera kompetente.

Percjellja e drejteperdrejte e punes edukativo-arsimore ne shkollë

Bashkëpunojmë me arsimtarët për përgaditjen e plan-programeve të reja të konceptit mësimor për klasën e nëntë .

Gjatë strukturimit të programit për punën e pedagogut në këtë vit shkollor vihen parasysh këto njohuri dhe nevoja të shkollës: - Vëzhgimi i notave të cilat janë dhënë në raportin për punën e shkollës gjatë vitit të kaluar. - Vazhdimësi në realizimin e programeve paraprake të pedagogut të shkollës.- Risi thelbësore të cilat janë përmbajtur si kërkesë e

konceptimit të dokumentit – Arsim fillor.-Bazë e programimit të punës së pedagogut në arsimimin fillor.

- Ligji për arsimin fillor

- Statuti i shkollës

- Angazhime vetjake në bazë të misionit të qëllimeve strategjike dhe modernizimit të arsimit në kontekst të programit nacional për zhvillimin e arsimit në RM.

- Planifikim zhvillimor të shkollës.

- Realizim të suksesshëm të projekteve:

PEP projekti me komponentët shoqërues, shkolla sipas dëshirës së fëmijës, Aftësitë jetësore. Gjithashtu duhen theksuar edhe projektimet e brendshme të shkollës dhe aktivitete të caktuara hulumtuese.

**KOMPETENCAT SPECIFIKE PËR PEDAGOG**

I. Punë me nxënës

Pedagogu kryesisht vepron në drejtim të krijimit të praktikës efektive arsimore dhe zhvillimore të teknikave dhe metodave përkatëse për përmirësimin e procesit të nxënies.Duke respektuar nevojat dhe karakteristikat individuale të nxënësve,pedagogu i këshillon, edukon dhe u ndihmon atyre që të përmirësojnë mënyrën e të mësuarit dhe sjelljes.

Ai praktikon metoda dhe mjete për punë educative me nxënësit.

Pedagogu zbaton modele bashkëkohore të udhëheqjes pedagogjike në situata të ndryshme educative në shkollë. Realizon punë edukativo-arsimore këshilldhënëse me nxënësit për tejkalimin e arsyeve për problemet në mësime dhe sjellje. U ndihmon nxënësve në përzgjedhjen e aktiviteteve të lira në përputhje me interesat e tyre.

- Mbështetje e nxënësve gjatë nxënies – të mësuarit

- Vëzhgim dhe mbështetje e zhvillimit të nxënësve

II. Punë me arsimtar

Pedagogu arsimtarëve u ofron ndihme profesionale ,konsulton ,mbështet ,planifikon - veçanarisht gjatë: planifikimit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore me ç,rast i merr si bazë planifikimet paraprake dhe rezultatet e të arriturave të nxënësve ,realizimin e mësimit me shfrytëzimin e metodave ,formave ,aktiviteteve ,mjeteve /resurseve përkatëse bashkëkohore ,notimin e nxënësve me qëllim që të mbështetet nxënia ,udhëheqjen e evidences dhe dokumentacionit pedagogjik ,organizimin e mbledhjeve prindërore dhe vëtëvlerësimin e punës së arsimtarëve.

- Ndihmon arsimtaret që të përzgjedhin dhe përgatisin instrumente për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e të arriturave të nxënësve dhe ti shfrytëzojnë ato në mënyrë përkatëse.
- Mbështetja e arsimtarëve gjatë planifikimit dhe realizimit të procesit edukativo- arsimor dhe vëtëvlerësimit.
- Mbështetja e arsimtarëve gjatë punës me nxënës
- Vlerëson apektet pedagogjike të librave shkollor.
- **Punë këshillëdhënëse – konsultative**
- *Detyra punuese të ndryshme të kësaj fushe*
- Punë konsultative-këshillëdhënëse me kuadrin mësimor, kujdestarët e klasave, psikologu dhe bibliotekisti i shkollës.
- Punë konsultative-këshillëdhënëse me drejtorin dhe anëtarët e tjerë të ekipit menaxhues dhe bashkëpunëtorë profesional.
- Punë konsultative-këshillëdhënëse me përgjegjësit e ekipeve profesionale dhe përgjegjësit e aktiveve dhe seksioneve.
- Punë këshillëdhënëse me anëtarë të organeve dhe degëve të shkollës.
- Punë këshillëdhënëse me arsimtarët – stazhistët.
- Punë këshillëdhënëse me prindërit.
- Punë këshillëdhënëse me nxënësit( të talentuar, me vështirësi në mësim, dhe me ngecje mentale).
- Punë këshillëdhënëse në kontekst të aftësimit dhe përparimit të procesit edukativo-arsimor.
- *Në këtë fushë do të realizohen këto detyra konkrete*
- Punë këshillëdhënëse me arsimtarët të cilët realizojnë mësim në klasat e nënta të arsimit fillor nëntëvjeçar.
- Punë këshillëdhënëse me udhëheqësit e bashkësive të klasave dhe udhëheqjes në nivel të bashkësisë shkollore prej kl. VI – IX, në lidhje me suksesin,vëzhgimin dhe proektimin e mësimit. Respektimin e të drejtave të tyre shfaqje pozitive, participimi i

tyre në sferat e jetës shkollor edhe përshtatja e interakcioneve demokratike me arsimtarët dhe drejtorinë e shkollës, respektimin e multikulturës në mes të gjitha subjekteve në mjedisin shkollor.
- Punë këshillëdhënëse – instruktive me përgjegjësit e aktiveve profesionale nga mësimi lëndor dhe klasor ne lidhje me aktivitetet e SIT-it. (Implementimi i të gjitha risive nga aktivitetet projektuese të theksuara te fusha e ndjekjes së mësimit, vlerësimi formativ me të gjithë komponentët, ndjekja e zhvillimit të portfoliove të arsimtarëve dhe nxënësve).
- Punë këshillëdhënëse me kuadrin arsimor dhe me prindërit e f.ëmijëve të cilët tregojnë sukses të dobët, pa rregullshmëri dhe disiplinë,
- Bashkëpunim me mjedisin lokal dhe punë instruktive me faktorët e jashtëm (NJVL. Mediat) në kontekst të promovimit dhe marketingut të shkollës

**III.** Punë me prindër

**Pedagogu** u ndihmon veçanarisht prindërve lidhur me llojin dhe mënyrat e mbështetjes që duhet t,ia sigurojnë fëmijës në procesin e të mësuarit ,me qëllim që ai të arrijë potencialin e vet, si dhe raport me edukimin e fëmijëve në shtëpi ( shprehi për nxënie ,shfrytëzim të kohës së lire , mënyra të komunikimit me fëmijët).

- Këshillime ,konsultime individuale dhe grupore me prindër

**IV.** Bashkëpunimi me bashkësinë

